



Republika e Kosovës
Republik a Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Raport nga Konferenca Ndërkombëtare:

PREZANTIMI I TRANSMETIMIT DIGITAL NË KOSOVË DHE RAJON- STRATEGJITË

3-5 dhjetor 2009, Prishtinë

Përbajtja

| | |
|--|----|
| Hyrje | 3 |
| Mediat në Kosovë dhe procesi i digitalizimit të transmetimeve në Kosovë | 5 |
| Digitalizimi në Region – | 6 |
| Strategjia për kalimin nga sistemi analog në sistem digital të transmetimit: Korniza ligjore dhe teknike, mësimet dhe përvojat | 6 |
| Përvoja e Shqipërisë | 6 |
| Përvoja në Bosnjë dhe Hercegovinë | 8 |
| Përvoja Kroate | 9 |
| Përvoja e Malit të Zi | 11 |
| Përvoja në Maqedoni | 14 |
| Përvoja në Slloveni | 16 |
| Planet dhe përgaditjet e medias në Kosovë për kalimin e transmetimit nga ai analog në digital | 19 |
| Pasqyrë e përgjithshme e UNT dhe marrëveshjes Gjeneva 06 | 21 |
| Alternativat teknike për planin frekuencor digital sipas standardeve të UNT-së | 23 |
| Mundësitet për koordinim dhe bashkëpunim me vendet fqinje për një plan alternativ frekuencor | 25 |
| Konkluzionet | 28 |
| Aneksi 1 – Fjalimi hyrës nga Jakup Krasniqi, Kryetar i Parlamentit të Kosovës | 29 |
| Aneksi 2 – Fjalimi hyrës nga Daut Demaku, Nën-kryetar i Këshillit të KPM | 31 |
| Aneksi 3 - Agjenda e konferencës | 33 |

Hyrje

Në organizim të Komisionit të Pavarur për Media, më 3-5 dhjetor 2009 Në Prishtinë u mbajt konferenca ndërkontaktore mbi strategjitet dhe përvojat nga procesi i kalimit në transmetimin digjital në Kosovë dhe rajon. Qëllimi i konferencës ishte prezentimi i procesit të digitalizimit të transmetimeve, diskutimi i sfidave e përvojave teknike dhe ligjore nga ky proces, si dhe fillimi i procesit të koordinimit frekuencor në mes të Kosovës dhe vendeve fqinje. Në konferencë ishin prezent përfaqësues të institucioneve Kosovare, përfaqësues të medias Kosovare, përfaqësuesit e agjencioneve përkatëse nga vendet e rajonit, përfshi Slloveninë, Kroacinë, Bosnjë e Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë dhe Shqipërinë. Përfaqësuesit e Serb isë, edhe pse nuk u paraqitën në konferencë.

Konferanca u hap nga kryetari i parlamentit të Kosovës z. Jakup Krasniqi, i cili shprehu përkrahjen për diskutimet e konferencës dhe shkëmbimin e përvojave në procesin e digitalizimit të transmetimeve dhe e cilësor këtë proces si të rëndësishëm për demokratizimin e mëtutjeshëm të shoqërisë përmes ofrimit dhe shpërndarjes së informacionit dhe si një proces të rëndësishëm në zhvillimin e mediave, biznesit dhe ekonomisë në Kosovë. Në emër të Komisionit të Pavarur për Media, nën kryetari i bordit të KPM-së z. Daut Demaku shprehu nevojën e shkëmbimit të përvojave dhe mësimave nga ky proces me vendet e rajonit, dhe tha se Kosova, pas kalimit të sfidave të mëdha në rregullimin e tregut mediatik në periudhën e paslufës, tani gjendet në fillim të procesit të digitalizimit dhe se kjo është tani sfida më e madhe posaçërisht nëse marrim parasysh pasojat e marrëveshjes Gjeneva 06 për transmetimet në Kosovë. Ai u shpreh se megjithëse frekuencat janë asete shtetërore, ato nuk njojin kufinj dhe kështu mund të shkaktojnë pengesa në vendet fqinje. Prandaj z. Demaku theksoi rëndësinë e ndërtimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit me vendet fqinje dhe falemnderoi agjencinet përkatëse të këtyre vendeve për marrëdhënie korakte me KPM-në.

Në konferencë fillimisht u prezantua gjendja aktuale e transmetimeve dhe mediave në Kosovë. Pastaj, përfaqësuesit e agjencioneve përkatëse nga vendet e rajonit prezantuan përvojat nga vendet e tyre me procesin e digitalizimit si nga aspekti teknik ashtu edhe ai ligjor. Roli i Unionit Ndërkombëtar për Telekomunikacion dhe pasojat e marrëveshjes Gjeneva 2006 ndaj transmetimeve analoge dhe digitale në Kosovë ishin fokus i pjesës së dytë të konferencës. Në konferencë u prezantua edhe një plan alternativ frekuencor nga Gjeneva 06, i cili do të plotësonte nevojat e Kosovës dhe njëkohësisht do të kujdesej për mos pengimin e transmetimeve digitale në vendet fqinje. Plani alternativ dhe mundësitet e bashkëpunimit dhe koordinimit të transmetimeve me vendet e rajonit ishte diskutimi përbillës i konferencës. Gjatë konferencës u shpreh gatishmëria për bashkëpunim dhe koordinim në mes të gjitha vendeve pjesëmarrëse në konferencë si dhe u cek nevoja për takime bilaterale në mes të agjencive përkatëse të vendeve nga rajoni. Si konkluzion nga konferenca doli nevoja për të krijuar

mekanizma për koordinim të procesit të digitalizimit, si brenda Kosovës ashtu edhe në mes të Kosovës dhe vendeve fqinje. Poashtu u shpreh nevoja për të konsultuar UNT-në rreth mundësive për të zgjidhur problemet e dala nga marrëveshja Gjeneva 06. Vendet fqinje shprehën gatishmérinë për tu koordinuar me Kosovën dhe për të akomoduar nevojat e saj. Poashtu edhe përfaqësuesit nga Kosova shprehën gatishmérinë për të mos interferuar në transmetimet digitale të fqinjëve. Moszgjidhja e problemit të alokimit frekuencor për Kosovën dhe moskoordinimit me vendet fqinje u konsiderua si një gjë që do të krijonte probleme në procesin e digitalizimit në gjithë rajonin.

Mediat dhe procesi i digjitalizimit të transmetimeve në Kosovë

Konferanca fillooi punimet me një prezentim nga znj. Naile Selimaj-Krasniqi e cila prezentoit të arriturat në sektorin mediatik në Kosovë nga koha e pasluftës. Rregullimi i transmetimeve pas lufte në Kosovë ka filluar në vitin 2000 përmes licensimeve të përkohshme dhe ky sistem ka funksionuar deri në korrik të vitit 2006 dhe është administruar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë. Në vitin 2006 themelohet Komisioni i Pavarur për Media (KPM), ndërsa në vitin 2009 KPM ka nisur procesin e licensimit afatgjatë. Veprimitaria e KPM-së rregullohet përmes ligjit për KPM-në dhe ligjit për Radiotelevizionin publik të Kosovës, të cilat poashtu janë në procedurë të amandamentimit. KPM ka autoritetin për krijimin e legjislacionit dytësor dhe përmes akteve nënligjore tenton që këto të bazohen në praktikat më të mira evropiane.

Znj. Selimaj-Krasniqi theksoi se në Kosovë ekzistojnë 110 subjekte transmetuese të licensuara përkohësisht, të cilat janë në proces të licensimit afatgjatë. Prej tyre, në Kosovë është një transmetues publik, që ka një kanal televiziv dhe dy radiostacione, 2 televizione private komerciale me transmetim nacional si dhe dy radiostacione me mbulesë nationale. Transmetuesit e tjere janë radiotelevizione në nivel lokal. Poashtu, ekzistojnë edhe subjekte transmetuese të kategorizuara si subjekte me fuqi të ulët, të cilat janë të destinuara për nevojat e popullatës minoritare dhe mbulojnë disa lokacione të vogla gjeografike. Nga transmetuesit, 66 janë në gjuhën shqipe, 32 në gjuhën Serb e, boshnjake, turke dhe rome. Si trashëgimi nga e kaluara, Kosova është e ndarë në 5 regjione transmetuese.

Në vitin 2007, KPM ka nxjerrë edhe rregulloren për rregullimin e transmetimit në sistem kabllor, gjë që ka rregulluar këtë formë të transmetimit të etabluar disa vite më herët. Tani në Kosovë kemi 10 operator të licensuar kabllor. Përmes këtij rrjeti kemi edhe televizione të cilat nuk shfrytëzojnë frekuencia por transmetojnë vetëm nëpërmes kabllit.

Znj. Selimaj-Krasniqi konkludoi se brenda 10 viteve skena mediatiske në Kosovë është zhvilluar dhe përmirësuar dukshëm. Tani sfida e radhës është që të kalohet nga transmetimet analoge në ato digitale dhe qysh tani mediat kanë filluar të veprojnë në këtë drejtim. Disa shtëpi mediatiske kanë krijuar pako programesh të cilat për shkak të mungesës së frekuencave janë duke transmetuar përmes rrjetit kabllor. Mirëpo, sipas znj. Selimaj-Krasniqi një gjë e tillë është shumë pozitive pasi këta transmetues po krijojnë platformat e tyre dhe janë të gatshëm të kalojnë lehtë në sistemin e ardhshëm të transmetimit digital. Në procesin e digitalizimit jemi në fazën e parë dhe këtu kanë rolin e vet institucionet e Kosovës, mediat si dhe autoritetet relevante nga vendet e rajonit. Znj. Selimaj-Krasniqi shprehu nevojën për të mësuar nga përvojat si dhe ndihmën e vendeve të tjera për të lehtësuar sa më shumë këtë proces në interes të publikut dhe mediave.

Digjitalizimi në Rajon-

Strategja për kalimin nga sistemi analog në sistem digital të transmetimit: Korniza ligjore dhe teknike, mësimet dhe përvojat

Përvoja e Shqipërisë

Përvojen nga Shqipëria, në emër të Këshillit Kombëtar të Radiotelevizionit (KKRT) e prezantoi z. Pirro Braço. Ai filloi me një prezantim të peisazhit audio-vizuel në Shqipëri. Transmetuesi publik, Radiotelevizioni Shqiptar, mbulon mbi 80% të territorit shqiptar me transmetim nacional përmes tri rrjetave rajonale si dhe përmes rrjetit satelitor. Transmetuesi publik poashtu ofron dy rrjete të radios kombëtare dhe tre regionale. Transmetuesit privat mbajnë tre rrjete kombëtare televizive në transmetim analog, Klan, TV Arbëria dhe Top-channel, të cilat mbulojnë tërë Shqipërinë me transmetim analog nacional, si dhe 80 rrjete transmetuesish regional dhe lokal të cilat mbulojnë një qytet deri në katër qarqe. Poashtu janë edhe 2 radio kombëtare komerciale, Top-Albania dhe Radio Plus 2 si dhe 53 radio lokale. Z. Braço poashtu theksoi se ekzistojnë edhe 64 rrjete kabllore me mbulim lokal si dhe 5 rrjete satelitore: Alsat, Digitalb, Super Sport, Vizion Plus dhe Tring.

Z. Braço tregoi se në Shqipëri për disa vite tani ekzistojnë edhe transmetuesit terrestrial digjital, edhepse si sistem i parregulluar. Megjithatë, ky sistem tani është i konsoliduar dhe KKRT e konsideron pasuri kombëtare e cila duhet të rregullohet, mirëpo duke ruajtur funksionimin e këtij sistemi. Rrjeti më i madh është ai i Digitalbit i cili mbulon një pjesë të madhe të territorit dhe përdor katër frekuencia. Ai vlerësoi numrin e abonentëve në këtë sistem të jetë më se 200 mijë. Ky rrjet përdor sistem dekoderësh që nuk mund të përdoren nga transmetuesit e tjera. Mirëpo, duhet theksuar se frekuencat që përdor Digitalb nuk respektojnë planin frekuencor Gjeneva 06. Përveç kësaj Digitalbi ofron edhe një shërbim mobil televiziv. Përveç Digitalbit, transmetime digitale ofron edhe platforma Tring si dhe Shijak TV, mirëpo këto dy janë të fokusuara në zonën e Tiranës. ç

Sa i përket licensimit të transmetuesve digjital, ky licensim është diktuar nga një rezolutë e Parlementit, e cila kërkonte licensimin e operatorëve digjital gjatë vitit 2008. Sifda këtu, sipas z. Braço, ka qenë në ate se ky licensim është dashur të kryhet pa një kuadër ligjor të plotë dhe pa pasur strategji të miratuar për kalim në transmetime digitale. KKRT ka ndejkur procesin e garës publike ku operatorët janë ftuar të konkurojnë për licensë. Ky proces ka qenë i përcjellë me probleme dhe pas disa shtyerjeve të afatit për konkurrim, ky proces dështoi në fillim të vitit 2009 pasi në afatin e fundit nuk u paraqit asnjë kandidat. Arsyet e këtij dështimi sipas palëve të përfshira në proces konsistojnë në mungesën e kuadtit ligjor të përcaktuar mirë, mungesën e një strategjie të miratuar për kalimin në transmetim digital si dhe kërkesat shumë të larta financiare (1 milion Euro asete, prej të cilave 10% do të ndaleshin si garanci, si

dhe pagesa të larta për licensë vjetore) për operatorët të përcaktuara në ligj, e të cilat u konsideruan si të papërballueshmë nga ta.

Sipas z. Braço, një problem me ligjin aktual në Shqipëri është se aty nuk përcaktohet qartë bashkëpunimi në mes të operatorëve dhe ofruesve të përmbajtjes. Poashtu, ligji përcakton që transmetimet të jenë në sistemin MPEG4 pasi që ky lejon efikasitet më të madh në shfrytëzimin e spektrit frekuencor, mirëpo kjo hasi në rezistencën e operatorëve aktual të cilët për momentin përdorin sistemin MPEG2. Këtu sipas z. Braço nuk ka ekzistuar komunikim i mirë në mes të KKRT dhe operatorëve për të definuar një periudhë tranzicioni i cili do të justifikonte kalimin në sistemin e ri.

Si pasojë e mosekzistimit të strategjisë së kalimit, ende ekzistojnë spekulime rreth çështjes së subvencionimit apo jo të dekoderëve digital nga shteti, gjë që shkakton ngadalsime në proces. Poashtu, forca a KKRT-së për të imponuar licensimin ishte e kufizuar politikisht pasi viti 2009 ishte vit elektoral.

Sa i përket gatishmrisë së Shqipërisë për të kaluar në transmetim digital, sipas z. Braço, është bërë një punë e madhe. Mirëpo, pasi ligji për transmetime digitale ka mangësi, Parlamenti Shqiptar ka ngritur një grup pune për hartimin e një ligji të ri të integruar i cili do të mbulonte të gjitha çështjet rreth transmetimeve në Shqipëri. Ndërkokë, Parlamenti ka ratifikuar marrëveshjen Gjeneva 06, e cila vendos baza të fuqishme për implementimin e rrjeteve digitale dhe në të njejtën kohë KKRT ka miratuar një rregullore për licensimin e transmetimeve digitale dhe po përgaditet për një garë të re për licensim. Poashtu edhe bazat taknike për ndërtimin e rrjeteve digitale në Shqipëri janë krijuar plotësisht si dhe janë përcaktuar frekuencat dhe caktimet frekuencore. Në këtë proces KKRT është ndihmuar shumë nga misioni i OSBE-së në Shqipëri si dhe nga autoritetit rregulator françez KSA.

KKRT ka propozuar edhe krijimin e një task-force që do të ishte e ngarkuar me përcjelljen e procesit të digitalizimit në Shqipëri gjatë tërë procesit të përcaktimit dhe implementimit të strategjisë së digitalizimit. Kjo task forcë do të ketë dy nivele, atë vendim-marrës të përbërë nga përfaqësues të qeverisë ku do të miratohen strategja dhe vendimet kryesore, dhe niveli teknik i cili do të përbëhet nga specialistë të fushave përkatëse.

Sipas z. Braço, problemi kryesor qëndron në implementimin e strategjisë deri në momentin e shuarjes së transmetimeve analoge. Sipas ligjit aktual, operatorit publik i ipet e drejta për ndërtimin e dy rrjeteve digitale kombëtare, që për mendimin e KKRT është një sasi shumë e madhe që tejkalon nevojat e operatorit publik. Strategja parashev tre rrjete kombëtare për operatorët privat. Poashtu strategja e propozuar parashev edhe operator regional. Sfida kryesore sipas KKRT-së është krijimi i mundësisë për kalim në transmetim digital për të gjithë operatorët analog. Për këtë qëllim është vendosur që një nga mbulimet e planifikuara kombëtare të zbërthehet në mbulime regionale dhe lokale. Ashtu, për secilin alotment janë bërë llogaritë e transmetimeve analoge dhe është caktuar numri i rrjeteve të nevojshme si në sistemi MPEG 2 ashtu edhe në atë MPEG4, me qëllim që të llogariten kapacitetet transmetuese dhe teknologjia e nevojshme që duhet vënë në funksion. Poashtu janë bërë edhe llogaritjet e kostos për sistemet e ndryshme si dhe nevojat e kostot e dekoderëve në skema të ndryshme subvencionimi. Sa i përket implementimit të strategjisë së kalimit, mendimi i KKRT-së dhe ekspertëve të jashtëm është se, qasja më e mirë e mundshme është ajo e ishujve digital, që është përdorur në Gjermani dhe Kroaci. Kjo

do të thotë së kalimi do të bëhet zonë pas zone, ashtu që të minimizohet periudha e simulkastit dhe si pasojë edhe të minimizohen shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemit analog dhe digital paralelisht. Këtu mund të ndjekën dy qasje, njëra që të fillohet nga zonat më të populluara, siç është Tirana, ose të fillohet në zonat me mbulesë minimale, ashtu që dëmi nga dështimet eventuale të jetë minimal. Sipas, z. Braço në Shqipëri qysh tani ekziston përvoja e pranimit të transmetimeve digitale dhe populata është e mësuar me sistemin e ri.

Në përgjithësi ekziston një rrezistencë ndaj tempoz së shpejtë për kalim që diktohet nga ligjet dhe politikat e aprovuara. Kjo rrezistencë është më e madhe nga operatorët e vegjël lokal të cilët tentojnë që maksimalisht të shfrytëzojnë rrjetet analoge të tyre ashtu që të nxjerrin përfitimet nga investimet e bëra dhe të shtyjnë nevojën për investime të reja. Një propozim për të zgjidhur këtë problem është që njëri nga rrjetet e parapara për televizionin publik të merret përsipër e ndërtohet nga shteti dhe të vihet në dispozicion të operatorëve ekzistues analog ashtu që ata të mos ngarkohen me shpenzime të mëdha financiare në ndërtimin e rrjetit digital. Një formë tjetër e propozuar është ofrimi i kredive shtetërore afatgjate dhe me kushte të mira për këta operator. Shembulli francez propozon që operatorët lokal të mos kenë nevojë të garojnë në tender, por që atyre automatikisht t'u ipet e drejta që bashkërisht të ndërtojnë rrjetin e tyre lokal. Mirëpo, kjo qasje kërkon ndërrimin e ligjit, i cili nuk lejon dhënen e frekuencave pa tender si dhe përsëri paraqet ngarkesa financiare për operatorët ekzistues. Një propozim tjetër i mundshëm është që shteti të subvencionojë ndërtimin e këtyre rrjetetëve regionale digitale, mirëpo mundësitet buxhetore shtetërore janë të kufizuara. Një formë e fundit është që të krijuhet një fond i zhvillimit digital me participimin e fondevë të shtetit, fondevë të ngritura nga procesi i licensimit dhe fondevë nga sektori privat.

Përvoja në Bosnjë dhe Hercegovinë

Znj. Amela Odobasic nga Agjencioni Rregulator për Komunikime prezantoi përvojat nga Bosnja dhe Hercegovina në procesin e digitalizimit. Ajo filloi me prezentimin e ambientit rregulator në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ajo theksoi se procesi i digitalizimit udhëhiqet nga një trup i vetëm që quhet DTT, i cili ka sekretariatin dhe grupet punuese për çështje rregullatore, përbajtje programore, grupet teknike dhe promovim, si dhe grupin për çështje socio-ekonomike.

DTT si forum koordinues është krijuar në vitin 2006 dhe në ndërkohë roli i tij është rritur shumë. DTT së bashku me sekretariatin dhe grupet punuese kanë mbajtur një numër shumë të madh takimesh gjatë të cilave është punuar drafti i parë i strategjisë, i cili i është dorëzuar komisionit parlamentar dhe në mars të vitit 2009 strategjia i është dorëzuar Këshillit të Ministrave të Bosnjë Hercegovinës, strategji kjo që është aprovuar në qershori të po këtij viti.

Strategjia është dokument i thukët i prezantuar në mbi 70 faqe dhe përban të gjitha gjërat që janë të rëndësishme për anën praktike dhe implementimin e digitalizimit. Qëllimi i strategjisë është të arriet që tranzicioni të bëhet deri në dhjetor 2011. Roli i rregulatorit duhet të jetë në kujdesin që procesi të implementohet si duhet. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, Rregulatori ka qenë ai trup i cili ka punuar në

draftimin, miratimin dhe tanë edhe implementimin e strategjisë, në mënyrë që të arrihet afati i 1 dhjetorit 2011. Rregullatori është marrë edhe me ndryshimin e sistemit të licensimit, përfshi edhe licensimin e kontentit, në mënyrë që sistemi të jetë sa më i përgaditur për tranzicionin.

Sipas znj. Odobasic, principi kryesor i punës duhet të jetë transparenta. Përmes diskutimeve publike dhe përfshirjes së të gjithë akterëve, shumë më lehtë arrihet pajtueshmëria dhe të gjithë mund të shohin benefitet e këtij procesi. Sa i përket monitorimit të radio frekuencave, komunikimi me vendet fqinje sipas znj. Odobasic është një gjë e nevojshme.

Planet për vitin 2010 janë që të fillojë procesi zyrtar i tranzacionit që do të përcillet me një fushatë informimi si dhe do të vendosen çështjet e subvencionimit të boksëve dhe definimi i kërkesave minimale teknike për bokset. Viti 2011 do të jetë vit interesant dhe gjatë këtij viti do të finalizohen përgaditjet për kalimin përfundimtar në transmetim digital deri në fund të tij.

Përvoja Kroate

Përfaqësuesi nga Këshilli për Media Elektronike nga Kroacia z. Damir Hajduk, filloi prezentimin e tij me parqitjen e trupave rregullues në Kroaci si dhe bazës ligjore ekzistuese dhe të ardhshme që rregullon procesin e kalimit në transmetim digital. Trupi qendror i cili udhëheq procesin e digitalizimit në Kroaci quhet Zyra Shtetërore Qendrore Administrative dhe ky trup përveç përgjegjësisë për mbikqyrjen e implementimit të strategjisë së digitalizimit merret edhe me çështje të tjera siç është penetrimi i broadband-it në Kroaci. Pasi që në Kroaci nuk ekziston një trup i vetëm rregulator, detyrat janë të ndara dhe Këshilli për Media Elektronike rregullon kryesisht përbajtjen derisa planifikimi frekuencor dhe operatorët rregullohen nga Agjioni Kroat për Komunikime Elektronike HAKOM.

z. Hajduk theksoi së është shumë e rëndësishme që të jetë vetëm një udhëheqës për tërë procesin dhe ky trup koordinon të gjithë akterët e tjera dhe merr përgjegjësinë për suksesin apo dështimin e procesit. Procesin e ndarjes së frekuencave dhe zgjedhjes së operatorëve të multipleksëve e udhëheq HAKOM-i, i cili ka qenë pjesë e negociatave mbi alotmentet në kuadër të marrëveshjes Gjeneva 06. Në këtë mozaik të agjacioneve, Ministria e Kulturës luan një rol të rëndësishëm në draftimin e ligjeve, derisa Agjioni për Media Elektronike merret me përbajtjen. Procesin e digitalizimit z. Hajduk e përshkruan si një projekt që mbështetet në vullnetin e mirë, ambiciet si dhe dividendën digitale e cila nxiret nga transmetuesit, ashtu që mund të mbështetemi në transmetuesit publik, komercial dhe lokal. Megjithëatë, nga transmetuesit, rolin më të rëndësishëm e kanë transmetuesit kombëtar.

Në përgjithësi transmetimi në Kroaci mbulohet nga tre ligje të cilat rregullojnë sektorin e mediave. Më i rëndësishmi nga ta është Ligji mbi Median, i cili është në proces të amandamentimit në parlamentin Kroat dhe do të përbajë edhe direktivat e Komisionit Evropian. Transmetuesi publik HRT rregullohet nga ligji për HRT-në dhe edhe ky ligj është në proces të amandamentimit ku ndër ndryshimet kryesore do të jetë kufizimi i hapsirës reklamuese, e cila për momentin është maksimum nëntë minuta në orë.

Strategjia për digitalizim u vlerësua si e suksesshme nga z. Hajduk edhe pse i gjithë procesi nuk ka përfunduar. Strategjia specifikon rolet e të gjithë pjesëmarrësve në proces. Kroacia planifikon në kalojë plotësisht në transmetim digital gjatë vitit 2010 dhe qysh në janarini e vitit 2009 kalimi i plotë është bërë në disa regjione të Kroacisë. Strategjia është publikuar dhe implementimi i saj është ndihmuar nga grupe punuese të cilat janë takuar rregullisht një herë në muaj, ndërsa tani këto takime janë të përvjetorë. Grupet punuese përbëhen nga të gjithë akterët dhe puna tani është e fokusuar në detaje të cilat janë shumë të rëndësishme. Sipas z. Hajduk strategjia nuk është një dokument statik dhe i shenjtë dhe ai duhet të ndërrohet dhe ti përshtatet zhvillimeve në teknologji dhe sektorin mediatik.

Një faktor i rëndësishëm në implementimin e strategjisë është liferimi i dekoderëve dhe si pasojë nevojiten partnerë të mirë në sektorin e shitjeve. Në Kroaci shteti ka subvencionuar një pjesë të kostos blerëse për bokset përmes një sistemi vauçerësh. Fillimisht kjo ka qenë 20 Euro për boks, mirëpo kjo tani ka rënë në 10 Euro pasiqë çmimi i pajsjeve vazhdimisht bjen dhe caktimi i një shume fikse për një kohë më të gjatë është problematik.

Kroacia ka të planifikuara 8 multiplekse. Kronologjia e aktivizimit të tyre do të jetë si në vijim. Katër transmetuesit kombëtar në Kroaci janë duke u transmetuar përmes Multipleksit A dhe B. Tani është duke u punuar në nisjen e Multipleksit D si cili do të bart transmetuesit regional. Sistemi i përdorur për transmetim tani është MPEG2, mirëpo ende nuk është marr vendimi se a do të përdoret përfundimisht ky apo sistemi MPEG4. Ky problem ka rrjedh nga fakti se procesi i digitalizimit në Kroaci ka filluar më herët dhe sistemi MPEG2 ka qenë më i standardizuar në atë kohë dhe poashtu edhe më i lirë. Kroacia është ndarë në nëntë regjione digitale derisa politikisht Kroacia ka 21 qarqe dhe digitalizimi ka shkaktuar disa probleme në transmetimin e lajmeve lokale në nivel të qarkut, pasi që kufinjtë digital nuk janë në përputhje me ato të qarqeve. Gjatë vitit 2009 janë zgjedhur dy operatorë të multiplekseve dhe këto funksionojnë përmes rrjetit njëfrekuencor (single frequency network) dhe transmetojnë në MPEG2. Ky sistem mundëson bartjen e pesë kanaleve në një multipleks dhe si pasojë janë edhe 6 hapsira të lira për transmetues kombëtar. Një mundësi për mbushjen e këtij kapacitetit sipas z. Hajduk është tenderimi i këtyre hapsirave transmetuese. Plani është që Multipleksi A të mbulojë 98% të territorit derisa Multipleksi B do të mbulojë 95%.

Kostoja e mbulueshmërisë rritet shumë pas arritjes së mbulueshmërisë nga 70%, derisa pas arritjes së mbulueshmërisë prej 90%, kostoja e rritjes së mëtutjeshme të mbulueshmërisë ngritet në mënyrë eksponenciale. Në përgjithësi, sipas z. Hajduk, digitalizimi kushtëzohet edhe nga topologjia dhe aspekti gjeografik i territorit i cili synohet të mbulohet me sinjal. Kroacia me mbi 1000 ishuj, male dhe shtrirje jo të përshtatshme gjeografike, paraqet një sfidë të madhe. Derisa për transmetim analog kanë ekzistuar 360 transmiter, për ta arritur mbulueshmërinë me sinjal digital prej 90.8% të territorit deri më tani në Kroaci ekzistojnë rreth 200 transmiterë.

Në esencë z. Hajduk thekson dy kriterë kryesore për ta vlerësuar këtë proces: Që sinjali të jetë në dispozicion të të gjithëve dhe që secila familje të ketë një set-top boks. Në Kroaci qysh tani kemi edhe operatorë DTH, mirëpo kemi edhe një shkallë të penetrimit të IPTV-së dhe televizionit kabllovik.

Sa i përket transmetueve, Kroacia ka katër kanale kombëtare ku sipas z. Hajduk transmetuesit komercial janë shumë të mirë siç janë CM Grupi si dhe RTL-i. Këshilli për Media Elektronike përkrah produksionin e këtyre transmetuesve duke subvencionuar prodhimin kryesish të lajmeve lokale, gjë që është treguar si praktikë e mirë për përkrahjen e pluralizmit dhe diversitetit në media. Një përkrahje e tillë jepet edhe për transmetuesit lokal / regional, të cilët konsiderohen si një element i rëndësishëm në procesin e digjitalizimit.

Çështja kyçe këtu është vetëqëndrueshmëria, ashtu që pasi të kalojnë në transmetim digjital transmetuesit të mund të mbijetojnë. Si pasojë e recessionit të hyrat e mediave në Kroaci, sipas z. Hajduk, kanë rënë dukshëm dhe sipas tij kjo ndoshta nuk është koha ideale për projekte të tillë të mëdha. Benefitet për transmetuesit janë se transmetimi digjital e ul koston në krahasim më transmetimin analog.

Sa i përket fushatës së informimit për procesin e kalimit, z. Hajduk theksoi se edhe pse publiku e ka pranuar argumentin e kualitetit më të mirë të fotografisë, duhet të bëhet më shumë për të spjeguar se çka në të vërtetë është dividenda digjitale, si do të ndikojë kjo në zgjedhjen e kanaleve të ofruara dhe zgjerimin e ofertës programore, kush do të financojë këtë proces, kush janë akterët e procesit. Fushatat duhet të kenë për synim sidomos njerëzit në moshë pasi ata do të binden më së vështiri. Sipas z. Hajduk përbajtja programore është shtytësi më efektiv.

Përvoja e Malit të Zi

Znj. Jadranka Vojvodic nga Këshilli i Agjencionit Transmetues foli mbi mozaikun mediatik në Mal të Zi, zhvillimet me ndikim në procesin e kalimit në transmetim digital, dilemat në këtë proces dhe përvojat nga ky vend.

Në Mal të Zi janë dy kanale televizive publike me mbulesë kombëtare që përdorin frekuencë analoge terestriale, derisa nuk ka asnjë transmetues në sistemin digjital tokësor. Poashtu ekzistojnë edhe katër kanale komerciale të cilat kanë pothuajse mbulesë të plotë kombëtare si dhe 14 kanale lokale apo regionale, e nga këto kanale 3 janë të themeluara nga kuvendet komunale.

Sa i përket operatorëve znj. Vojvodic theksoi se Agjencionit Transmetues ka licensuar gjashtë operatorë kabllovik, një IPTV operator si dhe nga një DTT dhe MMDS operator. Krahasuar me vendet e tjera mbulesa nga format e ndryshme të transmetimit dallon dukshëm, ku me sinjal analog terrestrial është mbuluar vetëm 44% i tregut, me DTT sistem 21%, MMDS 13%, IPTV 12% derisa kabllorët mbulojnë vetëm 10% të tregut. Rënia në shfrytëzimin e sinjalit analog nga shëpitë Malaziase në krahasim me një vit më parë sipas znj. Vojvodic mund të spjegojet me kërkësën për platforma të ndryshme dhe ofertë më të mirë programore.

Znj. Vojvodic theksoi se Mali i Zi ballafaqohet me problemet në arritjen e mbulueshmërisë së sinjalit për shkak të reliefit gjeografik. Në sistemin ekzistues analog në territorin Malazez janë 125 pika transmetimi nga të cilat arrihet vetëm 93% mbulueshmëri. Transmetuesit komercial transmetojnë nga 20 lokacione

dhe nuk arrijnë më shumë se 65-70% mbulueshmëri. Sipas znj. Vojvodic, ky fakt është i rëndësishëm kur të mirren parasysh investimet e nevojshme për kalim në transmetim digital dhe qëndrueshmëria e tyre.

Sa i përket legjislacionit, mediat rregullohen nga katër ligje si vijojn: Ligji mbi Mediat, Ligji mbi Transmetimin, Ligji mbi Komunikimet Elektronike dhe Ligji i ri mbi Transmetuesin Publik. Sipas znj. Vojvodiq, aprovimi i ligjit mbi media ka qenë një hap shumë pozitiv në procesin e digitalizimit. Ky ligj ka krijuar edhe Agjencionin për Transmetime si përgjegjës për licensimin si dhe ndarjen e frekuencave. Amandamentimi i ligjeve ekzistuese dhe aprovimi i ligjeve të reja sipas znj. Vojvodiq duhet të bëhet në mënyrë simultane, mirëpo një gjë e tillë nuk është bërë në Mal të Zi dhe për pasojë adoptimi i mëvonshëm i ligjit për komunikime elektronike ndryshoi kornizën rregullative në mënyrë drastike. Në këtë mënyrë funksioni i licensimit të mediave është ndarë nga ai për planifikim dhe koordinim të frekuencave dhe si pasojë është humbur elementi i koordinimit qëndror të sektorit mediatik në Mal të Zi. Poashtu është duke u draftuar edhe Ligji për Tranzicion në Transmetime Digitale, gjë që ka dalë si rekomandim nga strategjia për kalim pasi është menduar se është më mirë që elemente nga strategjia të jenë ligjërisht të obligueshme. Ndarja e kompetencave në mes të agjacioneve të ndryshme është kritikuar shumë përsa i përket çështjes së pavarsisë politike të institucioneve përgjegjëse. Si pasojë e kësaj tani në Mal të Zi është duke u zhvilluar një debat i gjërë rreth kësaj çështjeje.

Në vitin 2006 Agjacioni për Transmetime ka filluar punën në planin për kalim në transmetim digital me qëllim të arritjes së një strategjie funksionale për kalim. Agjacioni ka tentuar të arrij një përfshirje të gjërë të akterëve përfshirë qeverin, rregulatorët, asociacionin e transmetuesve, operatorët, konsumatorët, universitetin, etj., mirëpo, sipas znj. Vojvodiq përgjegjja nga këta akterë ishte e ulët. Si pasojë e kësaj Agjacioni për Transmetime me ndihmën e Misionit të OSBE-së në Mal të Zi përpiloj një draft dokument mbi planin për kalim. Ky dokument u plotësua përmes debateve publike dhe u promovua përmes prezantimeve, intervistave dhe mbulesës mediale. Plani ishte i paraprë si bazë për draftimin e strategjisë për kalimin në transmetim digital. Strategjia për digitalizim u aprovua nga Këshilli i Agjencionit për Transmetime në prill të vitit 2008.

Strategjia malaziase përbëhet nga pjesë rrregullatore, programore dhe ekonomike. Objektivat që dalin nga strategjia janë si në vijim. Afati i ndaljes së sinjalit analog sipas strategjisë duhet të jetë 31 dhjetori 2012 dhe kjo ende mbetet si cak. Një këshilë që del nga strategjia është se të gjithë servisët publik dhe transmetuesit ekzistues duhet ta kenë të sigurtë distribuimin free-to-air. Ky objektiv ka të bën shumë me ruajtjen përbajtjes lokale si dhe qëndrueshmërinë e transmetuesve lokal. Një objektiv tjeter ishte ndërtimi i teknologjisë neutrale ndaj ambientit i cili do të ndihmonte kalimin në transmetim digital dhe zhvillimin e infrastrukturës komunikuese. Poashtu strategjia dhe plani i kalimit ruan dhe mbron promovimin e kulturës, traditës dhe diversitetit kulturor, si dhe mbron njerëzit me aftësi të kufizuara.

Agjpcionet e përfshira në këtë proces përfshijnë Agjacionin për Transmetime, pastaj Agjacionin për Komunikime Elektronike, këshilli i të cilit caktohet nga qeveria, gjë që shihet si problematike. Nga qeveria janë të përfshira Ministria e Kulturës, Sportit, dhe Mediave, e cila merret me politikat mediatike si dhe Ministria e Transportit, Çështjeve Detare dhe Telekomunikimeve, e cila merret me politikat e komunikimit.

Përsa i përket planit për alokimin frekuencor në kuadër të marrëveshjes Gjeneva 06, Mali i Zi ka 7 frekuencia për mbulesë kombëtare në UHF dhe një në VHF. Të gjitha këto frekuencia kombëtare kanë nga 3 zona alotmenti, nga të cilat njera ka edhe sub-alotmentin për Podgoricën. Sipas strategjisë, transmetimi do të bazohet në rrjetet një frekuencore (single frequency network) aty ku ka mundësi teknike përsa i përket sinkronizimit. Sistemi i kompresimit do të jetë MPEG4.

Sa i përket infrastrukturës, Qendra Transmetuese e Malit të Zi është baza kryesore e sistemi transmetues. Në vitin 2008 kjo qendër nisi një sistem të radio relejëve digital të bazuar në platformë të internetit. Ky sistem ka 38 pika transmetuese të lidhura me kapacitet prej 155 deri 622 megabit për sekondë. Ky sistem për një kohë u konsiderua si bazë e mirë për kalim në transmetim digital, mirëpo Agjioni Transmetues zgjodhi sistemin kompresues MPEG2 dhe kështu që kjo tani parqet pengesë. Sipas znj. Vojvodic infrastruktura dhe përkrahja për infrastrukturë është një çështje shumë e rëndësishme dhe se pa një përkrahje të tillë interesimi i operatorëve për të investuar në këtë infrastrukturë nuk do të ishte i mjaftueshëm.

Financimi i kalimit në transmetim digital do të bëhet kryesisht nga buxheti shtetëror, mirëpo ky proces është përkrahur edhe nga fondet IPA 2009 të Komisionit Evropian. Komisioni Evropian ka financuar pajisje dhe trajnime për transmetuesin publik Malazias dhe stafin e Qendrës Transmetuese të Malit të Zi, kjo me qëllim të asistimit të kalimit në transmetim digital. Trajnimet e stafit janë në formë të vizitave studimore në vendet e BE-së. Pjesa e përkrahjes në pajisje ka të bëjë me blerjen e transmetuesve digital, ku nëntë nga ta do ti financiojë Qeveria Malaziase si bashkëfinancues derisa BE-ja do të financojë pajisjet për 30 lokacione transmetuese digitale shtesë, të gjitha këto për të nisur procesin e krijimit të multipleksit të parë. Mirëpo, sipas znj. Vojvodiq ngecjet në reformimin e legjislacionit si dhe ndarja e paqartë e kompetencve në mes të regulatorëve qeveritar dhe të pavarur mund të rrezikojnë përkrahjen nga BE-ja.

Sa i përket multipleksëve, një dilemë që ende nuk është zgjidhur është ajo nëse multipleksi i parë duhet të dedikohet vetëm për transmetuesin publik apo të jetë i hapur edhe për televizionet komerciale. Për momentin transmetuesi public RTCG nuk mund të mbush gjithë kapacitetin e një multipleksi dhe dedikimi i multipleksit vetëm për të do të ishte humbje e kotë. Një dilemë tjetër sipas znj. Vojvodiq është niveli i mbulueshmërisë që mund të konsiderohet i mjaftueshëm për të bërë shymbjen e sinjalit analog, a është kjo 90% apo ndonjë vlerë tjetër. Kjo për Malin e Zi është sidomos problematike duke marrë parasysh territorin dhe terrenin. Poashtu edhe periudha e transmetimit paralel e njojur si simulkast është një dilemë e pasqaruar. Për sa i përket përgjegjësisë dhe rolit të mediave, znj. Vojvodiq u shpreh se transmetuesi publik duhet të ketë rolin primar shtytës në këtë proces dhe se ai duhet të përkrahet jo vetëm në aspekt ligjor por edhe financiar që të udhëheq këtë proces nga këndi i mediave. Mali i Zi i jep një rëndësi të veçantë transmetimit të programit pa pagesë dhe qëllimi këtu është që transmetimi i lirë të përkrahet ashtu që pjesa më e madhe e popullatës të kenë qasje në të. Format e tjera të transmetimeve me pagesë janë duke u zhvilluar dhe kjo pastaj mbetet si zgjedhje e qytetarëve. Në këtë aspekt roli i qeverisë pritet kryesisht në drejtim të subvencionimit të kostos për blerjen e pajisjeve pranuese, mirëpo edhe kjo duhet të jetë e kufizuar, targetuar dhe neutrale.

Përvoja në Maqedoni

Përvojën nga Maqedonia e prezantoi z. Zoran Stefanovski nga Këshilli për Radio-Difuzion i Republikës së Maqedonisë. Si agjencion Këshilli është organ i pavarur rregulator i cili ekziston nga viti 1997. Ky agjencion ka pasur për detyrë të zhvillojë strategjinë për zhvillimin e radio-difuzionit në Maqedoni si dhe për digitalizimin e transmetimeve. Në Maqedoni poashtu ekzistojnë edhe Agjenconë për Komunikim Elektronik si dhe ndërmarrja publike që quhet Radio-Difuzioni Maqedonas.

Strategjia për sektorin radio-difuziv është aprovuar në vitin 2007 dhe kjo strategji përfshin edhe pjesën për digitalizimin e transmetimeve. Qasja në Maqedoni ka qenë pak më specifike dhe sipas z. Stefanovski edhe pse mund të tingëlloj e çuditshme, kjo qasje ka funksionuar mirë.

Problemi i parë me të cilin është ballafaquar Maqedonia ka qenë ai i financimit të digitalizimit, i cili ka qenë e pamundur të financohet nga qeveria Maqedone, së paku në afatet që ishin paraparë. Për këtë arsyë në Maqedoni është organizuar një tender ndërkombëtar në të cilin janë ftuar të marrin pjesë të gjithë telekom-operatorët nga e gjithë bota. Kushtet e tenderit kanë qenë që fituesi mund të marr më së shumti të drejtën për 3 multiplekse. Qëllimi i kësaj ka qenë që ky tender të jetë atraktiv për konkurentët e jashtëm dhe të ketë sens biznesi. Maqedonia sipas Gjeneva 06 ka alotmente me kapacitet për 8 multiplekse kombëtare plus 1 multipleks për Shkupin. Tenderi është shpallë nga Agjencion i për Komunikime Elektronike pasi që ka qenë në pyetje operatori i rrjetës publike komunikuase. Ky tender është fituar nga Telekomi Slloven, i cili menjëherë pas kësaj ka filluar realizimin e projektit dhe deri tani, brenda më pak se një viti, është arritur mbulueshmëri me sinjal digjital prej 81% të popullatës së Maqedonisë.

Sa i përket anës teknike të kapacitetit të një multipleksi, edhe pse fillimisht është menduar se do të shkojnë 8-10 kanale për multipleks, përmes një softueri special është arritur që të futen 14 kanale në një multipleks. Z. Stefanovski ofroi mundësinë për ndarjen e të gjitha informatave teknike rreth zgjidhjeve për të arritur këtë kapacitet. Ai theksoi se për momentin në Maqedoni transmetohen 43 kanale televizive digitale si dhe 6 radio-stacione kombëtare.

z. Stefanovski pastaj foli për kushtet shtesë që i janë vënë operatorëve në tender ashtu që të mbrohet interesë i qytetarëve si dhe i ofruesve të programeve. Sipas tij, në mënyrë që të kufizohet mundësia që vetë operatori në të ardhmen të kalojë në pozitë të rregulatorit, operatorit i janë vënë kushte ku ai duhet të transmetojë papagesë të gjitha kanalet e servisit publik (3 kanale televizive) si dhe deri në momentin e ndaljes se sinjalit analog të transmetojë edhe 5 kanale të tjera komerciale kombëtare pa pagesë shtesë. Operatori ka pranuar këto kushte si dhe ka shtuar poashtu edhe 2 kanale të tjera kombëtare satelitore. Operatori ka nënshkruar kontratë me secilin nga transmetuesit për regullimin e të drejtave autoriale. Operatori mund të zgjedh të mos ri-transmetojë kanalet kombëtare satelitore maqedone, mirëpo operatori nuk ka mundësi zgjedhjeje kur vjen puna te kanalet terrestriale kombëtare. Të gjitha kanalet që janë emetuar papagesë deri tani në Maqedoni, duhet të vazhdojnë të emetohen në këtë formë nga operatori digjital ashtu që publiku të mos mund të hetojë asnjë ndryshim. Qytetarët tani mund të blejnë set-top kutinë dhe kjo të mbetet e tëra apo edhe mund të hyjnë në

marrëveshje kontraktuale me operatorin dhe të marrin pajisjen papagesë. Sa i përket set-top kutive, Maqedonia është furnizuar me 120,000 set-top kuti qysh tani. Të gjithë dekoderët (set-top box) duhet të jenë inter-operativ ashtu që nëse hyn një operator i ri të mund të përdoren të njejtat kuti.

Në Maqedoni nga nëntori i vitit 2009 ka filluar periudha e simulkastit dhe transmetimet shkojnë paralelisht në sistem analog e digital. Për momentin transmetimi në platformën digitale terrestriale është papagesë dhe plani është që nga muaji mars 2010 të kalohet në transmetim të koduar. Parapagimi për komplet multipleksin është përafërsisht 8 euro për muaj dhe nëse hyet në kontratë me operatorin atëherë set-top boksi ipet papagesë nga operatori. Edhe pas marsit, qytetarët të cilët nuk dëshirojë të paguajnë për të gjitha programet në multipleks do të mund të shiqojnë papagesë tre kanalet televizive publike si dhe 5 kanale kombëtare komerciale, mirëpo në këtë rast vet qytetari duhet të blejë set-top boksin. Poashtu, pasi që të bëhet edhe digitalizimi regional, qytetarët do të mund të shiqojnë edhe programet ekzistuese regionale dhe lokale papagesë.

Një multipleks automatikisht është rezervuar për ndërmarrjen publike Radio-Difuzionin Maqedonas, e cila nuk është dashur të konkurojë në tenderin e shpallur dhe kjo sipas z. Stefanovski është parë si interes kombëtar. Për shkak të pamundësive për të ndërtuar rrjetin e vet, Radio-Difuzionit Maqedonas i është dhënë në shfrytëzim me qira nga operatori komercial pajisja rezervë (back-up) e saj. Qeveria Maqedone ka ndarë mjetet për ndërtimin e multipleksit vetanak për Radio-Difuzionin Maqedonas dhe plani është që përmes këtij multipleksi të ofrohen të gjitha kanalet kombëtare maqedone. Në këtë mënyrë në multiplekset ekzistuese lironet hapsira për 15 kanale televizive që mund të zevendësohen me kanale të huaja dhe në këtë mënyrë oferta totale për qytetarin përmes transmetimit digital tokësor do të ishte rreth 56 kanale.

Përveç transmetimit digjital terrestrial, në Maqedoni ekzistojnë edhe rrjeta të fuqishme të operatorëve kabllovik, të cilët kanë një penetrim të tregut prej 60%. Poashtu edhe Telekomi Maqedon ofron një paketë televizive përmes platformës IPTV (internet televizioni). Kjo platformë poashtu ofron sistem jo-linear siç është qasja në video-tekën e Telekomit Maqedon përmes formës së video-on-demand (video në bazë të kërkesës). Sipas z. Stefanovski, të gjithë operatorët në Maqedoni janë financiarisht të fuqishëm dhe në Maqedoni është arritur nivel i tillë i zhvillimit të këtij sektori që të mos ketë probleme rreth çështjeve siç janë të drejtat autoriale, edhepse këtu ka ende probleme me disa rrjete më të vogla kabllovikë.

z. Stefanovski vazhdoi me diskutimin rreth dilemave me të cilat Maqedonia ballafaqohet tani. Sipas tij, të gjithë akterët kanë qenë të befasuar me shpejtësinë me të cilën ka filluar dhe pothuajse përfunduar ky proces. Mirëpo, dilema tani është rreth asaj se kur duhet të ndërpritet sinjali analog dhe cilat janë ato kushte që duhet të plotësohen për të bërë këtë. Çështja është se nuk mundet aq thjeshtë vetëm të ndërpritet sinjali analog pasi ekziston obligimi ndaj qytetarit. Në të kaluarën, nën menaxhimin e Radio-Difuzionit Maqedonas, transmetimi analog ka mbuluar rreth 98% të popullatës. Kjo është një çështje problematike pasi që sinjali digjital ka specifikat e veta dhe lehtë arrihet 95%, mirëpo për ta shtuar këtë mbulesë edhe për 3% është shumë vështirë. Sipas z. Stefanovski 3% të fundit mund të kushtojnë 10 fish më shumë se sa 30% e para. Në mënyrë që të mbulohet ai 3% i fundit, që përfshinë vendet e largëta rurale, duhet ndërtuar një sistem me shumë pika transmetimi dhe pika repetitorësh. Z. Stefanovski

theksoi se koston e këtij 3% të fundit në fakt duhet ta mbulojë Radio-Difuzioni Maqedonas gjegjësisht Qeveria.

Për t'iu përshtatur zhvillimeve të shpejta në teknologji dhe nevojës për kalimin nëpër procesin e digitalizimit, sipas z. Stefanovski Maqedonia ka zgjedhur një rrugë paksa të çuditshme duke e përshtatur ligjin për komunikime elektronike. Poashtu, qasja ka qenë e tillë që është negocuar me secilin operator të komunikimeve publike dhe me ta individualisht është nënshkruar një protokol me të cilin ata janë obliguar që të plotësojnë disa kushte elementare të cilat janë futur në protokol.

Zhvillimi i sistemit të transmetimit digital sipas z. Stefanovski gjithësesi duhet të rregullohet me ligj, mirëpo dilema është nëse sistemi duhet dhe mundet të ndërtohet me kapacitete vetanake, apo duhet përfshirë ndonjë partner nga jashtë siç ka bërë Maqedonia. Me këtë proces, sipas z. Stefanovski, Maqedonia ka improvizuar dhe rrezikuar shumë, mirëpo për një kohë të shkurtë poashtu ka arritur shumë.

Z. Stefanovski përfundoi prezentimin e tij duke theksuar se, edhe pse mund të mësohet nga përvojat e të tjera, secili vend ka specifikat e veta dhe se organet rregullatore duhet të gjinden dhe të bëjnë zgjidhje përkatëse për situatat në të cilat e gjejnë veten dhe se nuk ka një recept përmes të cilit duhet të bëhet digitalizimi.

Përvoja në Slloveni

Përvoja Sllovene u prezantua nga znj. Tanja Kersevan Smokvina dhe z. Miha Kriselj nga Agjencioni për Komunikime Postare dhe Elektronike, trup që ka rolin e regulatorit të përbajtjes. Sipas z. Kriselj, kjo praktikë e ekzistimit të rregulatorit i cili ekskluzivisht merret me përbajtjen është e rrallë në Evropë, dhe agjenci të ngajshme ka vetëm në Britani të Madhe dhe Bosnjë.

Sllovenia ka filluar me transmetime digitale tokësore në vitin 2006 përmes ndarjes në mënyrë automatike të multipleksit të parë Slloven për televizionin publik në bazë të ligjit mbi këtë radio-televizion. Pas kësaj, Sllovenia shpalli një tender ndërkombëtar për operatorin e multipleksit të dytë. Në këtë tender u paraqitën tre kompani që vinin nga Luksemburgu, Austria dhe Norvegjia. Fituesi i tenderit ishte kompania Norvegjeze "Norkring", e cila ka obligim për transmetimin e së paku 8 kanaleve televizive të cilat kanë licensë në Slloveni si transmetues digital tokësor.

Sipas z. Kriselj, multipleksi publik A tani mbalon rreth 85% të popullatës, mirëpo multipleksi B nën-menaxhimin e Norkringut nuk ka filluar ende.

Sa i përket kornizës ligjore dhe obligimeve, multipleksi A duhet të mbulojë 95% të popullatës dhe të arrijë në një konsto sa më të ulët. Një gjë e tillë është kundërshtuar nga kanalet komerciale, të cilat dëshirojnë të kenë ndikim në nivelin e mbulesës që do të arrihet pasi mbulueshmëria me 95% të territorit është shumë e shtrenjtë të arrihet dhe në shumicën e rasteve sipas z. Kriselj kanalet komerciale nuk e dëshirojnë këtë. Agjencioni ka përgjegjësinë që të monitorojë multipleksin A,

funkcionimin dhe çmimin e tij, ashtu që ai të jetë i gatshëm të ndajë kapacitetin e tepërt. Për këtë arsyesh edhe agjencioni ka marrë vendim që të ndajë multipleksin në dy pjesë, njëra për kanalet televizive publike dhe pjesa tjeter për kanalet televizive komerciale. Licensa për multipleksin B është lëshuar në dhjetor të vitit 2008 dhe fituesi i licensës ka obligime më të vogla për mbulesë të sinjalit, që është rreth 85%. Çmimi i ofruar nga Norkring ka qenë 360,000 Euro për kanal për mbulesë kombëtare, që njëkohësisht ka qenë edhe çmimi më i ulët i ofruar.

Ligji në Shloveni specifikon se operatori nuk mund të transmetojë kanale të cilat nuk kanë licensë digitale të lëshuar nga agjencioni. Kështu në fakt në Shloveni ekzistojnë dy licensa që lëshohen, njëri për kanalin, ndërsa tjetri për frekuencën e cila i ipet operatorit. Prandaj, operatori nuk i ka duart e lira për të zgjedhur progamin në multipleks. Sipas z. Kriselj, pasiqë multipleksi B nuk është në operacion, shumica e kanaleve relevante dhe esenciale duhet të kalojnë dhe transmetojnë në multipleksin A. Pas aktivizimit të plotë të multipleksit B, kanalet komerciale duhet të kalojnë në këtë multipleks. Sipas z. Kriselj, çmimi i caktuar nga agjencioni për transmetim në multipleksin e parë pat skaduar në prill të vitit 2009 dhe çmimi i ri i caktuar nga operatori u bazua në kosto. Kjo shkaktoi pakënaqësi te operatorët komercial të cilët vendosën të dalin nga multipleksi. Në atë kohë multipleksi B nuk ishte në operim pasi që nuk kishte pajtim në mes të operatorit dhe kanaleve televizive të licensuara për transmetim digjital dhe kjo situatë krijoi një problem të madh. Operatori i multipleksit B në atë kohë mbante pozitën se nuk do të fillojë ndërtimin e rrjetit derisa një numër i mjaftueshë i kontratave të mos jetë nënshkruar me transmetuesit. Në anën tjetër, transmetuesit nuk ishin të pajtimit me nënshkrimin e kontratave pa parë rrjetin e ndërtuar dhe testuar. Kjo solli deri te një argument cirkular, i cili bartëte koston e pagesës së dyfishtë për të dy infrastrukturat, analoge dhe digitale.

Zgjidhjen në këtë situatë në Slloveni e ofroi qeveria, e cila gjeti një formë për të përkrahur procesin përmes subvencionimit të pjesërishëm. Për të kontrolluar kostot e simulkastit, qeveria shpalli konkurs për trasnmetuesit për t'ua financuar pjesërisht kostot e kalimit në transmetim digital. Për ti ikur kendërthënieve me rregulloret strikte të Komisionit Evropian për moslejim të subvencionimit, konkursi ishte për fonde të cilat do të financonin vetëm transmetimin në rrjetin analog edhe atë gjatë periudhës së simulkastit. Mirëpo, nëse përkrahja është nën 200,000 euro për aplikant në periudhë 3 vjeçare atëherë kjo është në pajtim me rregulloret e BE-së. Aplikantët për këto fonde duhej ti plotësonin disa kushte siç janë: të ketë një frekuencë të alokuar të cilën e përdor, të jetë transmetues në analog, të ketë licensë digitale dhe të ketë mundësitetë teknike për të hyrë në multipleks si dhe kontratën me operatorin. Kjo qasje u regua e suksesshme dhe, edhe pse ende nuk ka multipleks B, të gjitë transmetuesit do të transmetojnë për momentin vetëm në multipleksin A.

Deri në këtë moment operatori i multipleksit B ende nuk ka filluar ndërtimin e rrejtit edhe pse ka indikuar se do të fillojë të përdor frekuencën deri në afatin e fundit. Nëse nuk fillon të shfrytëzojë frekuencën deri në dhjetor 2009 operatori do të humb licensën për përdorimin e frekuencës. Ligji në Shloveni specifikon që nëse licensa nuk përdoren brenda një viti ajo automatikisht humbet pa asnjë mundësi kthimi. Kjo vonesë me operatorin e dytë ka për pasojë pamundësinë e shfrytëzimit të multipleksit B për të ndihmuar në procesin e kalimit (switch over) në transmetim digital.

Një çështje tjetër e paplanifikuar teknike është edhe kodimi i zërit. Fillimisht është specifikuar vetëm kodimi i videos derisa nuk është specifikuar kodimi i zërit. Kjo është me rëndësi pasi ka set-top bokse te ndryshme që mund të mospërkrashin disa lloje të kodimit të audios.

Fushata për vetëdijësimin e publikut fillon në dhjetor 2009 dhe në këtë kohë do të fillojë edhe periudha e tranzicionit.

Znj. Kersevan-Smokvina vazhdoi prezantimin e përvojës Sllovene duke thënë se fillimisht kanë pasur plane ambicioze, por në fund shumë gjëra kanë dalur si të pamundura për shkak të mungesës së sigurisë dhe problemeve në implementim. Ajo theksoi se për secilin kanal që dëshiron të transmetojë në sistem digjital duhet licensuar përmes tenderit publik. Gjatë procesit të tenderimit, pa marrë parasysh kapacitetin e shtuar që ofron ky sistem, nuk ekziston edhe gjithëq interesim nga ofruesit e përbajtjes, e cila do të ishte interesante dhe do ta ndihmonte procesin e tranzacionit. Për këtë proces me rëndësi është që kanalet që licensohen të kenë përcjellje të gjërë në popullatë ashtu që tranzicioni të bëhet më lehtë.

Sipas znj. Kersevan-Smokvina, në Slloveni për momentin më pak se çereku i shtëpive janë ende të varura nga sinjali terrestrial për televizion dhe ky numër është vazhdëmisht duke rënë, kryesisht për shkak të rritjes së pjesës së tregut të mbuluar nga IPTV. IPTV në Slloveni është një tregim i suksesshëm dhe ofron një pako televizive të pasur. Çështja sipas z. Kersevan-Smokvina është se si të ndërtohet një platformë digitale terrestriale e cila do të ishte konkurente në tregun e transmetimeve. Me rregullimin ligjor që ka Sllovenia për momentin kjo është e pamundur. Pasi në Slloveni është rasti që jo shumë kanale televizive janë duke garuar për të hyrë në platformën digitale, dhe si pasojë kapaciteti i transmetimit në këtë platformë më nuk është resurs i kufizuar, atëherë duhet parë mundësitetë e relaksimit të rregulloreve për licensimin e transmetuesve. Do të duhet lënë më shumë hapsirë për operatorët që të krijojnë modelet e tyre të biznesit, ofertat e tyre të përbajtjes, dhe duhet lejuar mundësinë e lidhjes së marrëveshjeve me ofruesit e përbajtjes apo operatorët e tjera. Një kombinim i kanaleve papagesë me një grup kanalesh me pagesë mund të kontribuojnë për një të ardhme të suksesshme për këtë platformë.

Viti 2010 në Slloveni është vit shumë i rëndësishëm për implementimin e platformës digitale. Qëllimi është që të mos lejohet që asnjë qytetar të ballafaqohet me fotografi të zezë në ekranet e tyre në ditën e shkyqjes.

Planet dhe përgaditjet e medias në Kosovë për kalimin e transmetimit nga ai analog në digjital

Mbi planet dhe përgaditjet e medias në Kosovë për kalim në transmetim digjital, në emër të Asociacionit të Mediave të Pavarura Elektronike të Kosovës (AMPEK) foli znj. Afërdita Saraçini-Kelmendi, e cila filloi duke përbledhur sfidat në procesin e digitalizimit të transmetimeve që për Kosovën janë të dyfishta. Kategoria e parë e sfidave ka të bëjë me problemet dhe kostot e këtij procesi me të cilat ballafaqohen të gjitha vendet, ndërsa kategoria e dytë ka të bëjë me problemet që lidhen me pozitën politike të Kosovës dhe problemet të cilat asaj i paraqiten jo rallë edhe me qëllim.

Duke qenë se Kosova u la jashtë procesit të planifikimit të transmetimeve Gjeneva 06 nga UNT-ja si dhe mospjesëmarrjes në Konferencën Rajonale të Radio-komunikacionit për planifikim të transmetimeve digitale tokësore, ajo ballafaqohet me një situatë ku nuk ka alternativë tjetër përvèç se të bëjë zgjidhje brenda kufizimeve që i ka, por pa dëmtuar procesin dhe ofrimin e shërbimit për qytetarët e saj. Znj. Saraçini-Kelmendi përmendi se në të kaluarën Kosova ka qenë pjesëmarrës me ingeranca të plota, përfshi edhe të drejtën e vetos, në konferenca dhe procese të ngjajshme siç ishin ato në vitet 1968 dhe 1978, kur edhe ka qenë e përfaqësuar në UNT si anëtare e Federatës së ish-Jugosllavisë. Kosova sot ende funksionon me planin e atëherëshëm radio-difuziv. Të drejtën për përfaqësim Kosova e ka pasur edhe nën administrimin e Kombeve të Bashkuara, mirëpo një gjë e tillë nuk u lejua nga UNT-ja. Fatkeqësisht, sipas znj. Saraçini-Kelmendi, pjesëmarrësit, përfshi këtu edhe vendet fqinje, në Gjeneva 06 si dhe në konferencën rajonale nuk kishin mirëkuptim për Kosovën dhe përfshin se herët a vonë digitalizimi radio-difuziv do të implementohej edhe në Kosovë. Si pasojë Kosova mbeti jashtë këtyre marrëveshjeve dhe e privuar nga e drejta për shfrytëzim legal të resurseve të veta natyrore dhe menaxhimi iu la në mënyrë arbitrale Serb isë.

Si reagim ndaj kësaj, AMPEK-u së bashku me të gjithë akterët relevant në Kosovë në vitin 2006 publikuan një kumtesë të përbashkët me shkrim ku u cek nevoja e njohjes së të drejtës së Kosovës për planifikim të brezit frekuencor dhe përpilimit të strategjisë së vet për tranzicionin në radio-difuzion digjital, i cili do të merrte parasysh veçantitë, specifikat, nevojat dhe kërkesat e Kosovës dhe të shoqërisë kosovare. Atëbotë, kumtesa rekondonte krijimin e grupeve punuese për çështje teknike, ligjore, financiare dhe të përbajjes dhe që këto grupe të ofronin një udhërrëfyes se si do të bëhej tranzicioni në mënyrë sa më optimale. Mirëpo, puna në përpilimin e Planit Strategjik për digitalizim në Kosovë ende nuk ka filluar.

Znj. Saraçini-Kelmendi vazhdoi duke nënvizuar pozitën e AMPEK-ut se nuk do të pranohet çfarëdo zgjidhjeje joadekuante me arsyetimin e vonesave në proces apo arritjes së ndonjë standardi ndërkombëtar. Këtu duhet të kihet parasysh se transmetuesit ekzistues, që sot identifikohen me një frekuencë apo rrjet frekuencash, me këtë proces do të humbin atë frekuencë duke u shkrirë në një

platformë të kanaleve digitale. Përfitimet nga ky proces janë poashtu evidente. Kursimi i brezit frekuencor dhe hapja e mundësive për të lansuar kanale të reja janë të mirëseardhura nga mediat. Mirëpo, duhet pasur kujdes që këto përparësi të mos keqpërdoren nga grupe të ngushta interesit, pa përjashtuar këtu edhe klanet politike.

Çështja kryesore te transmetimet digitale tokësore nga këndvështrimi i mediave është se nëse transmetuesit ekzistues nuk do të transmetohen në këto platforma ata do të pushojnë së transmetuari pasi nuk posedojnë frekuencë vetanake. Një shembull i tillë është në Gjermani ku një numër kanalesh lokale në disa lande kanë pushuar së transmetuari brenda nate, për arsyen se operatori i platformës digitale filloj të faturojë këto kanale me shuma shumë më të lartë për shërbimet e reja digitale. Ky problem nuk mundi të zgjidhet as nga strukturat rregullatore të këtyre landeve. Si pasojë, komisionet lokale të landeve u desh të vet financojnë ndërtimin e rrjetit tokësor të veçantë për mediat lokale, mirëpo një gjë e tillë morri së paku tre vite dhe dëmi që iu shkaktua disa mediave ishte i pariparueshëm.

Për të evitar situata të tilla dhe për të ruajtur pavarsinë informative, AMPEK-u angazhohet plotësisht për të ndihmuar në ndërtimin e kornizës adekuate ligjore dhe për të avokuar për mbarëvajtjen e këtij procesi. Në këtë drejtim, AMPEK-u poashtu përkrah punën e KPM-së për të filluar planifikimin frekuencor për transmetime digitale tokësore, i cili dallon nga planifikimi i paraparë në kuadër të marrëveshjes Gjeneva 06. Këtu znj. Saraçini-Kelmendi theksoi se ky planifikim duhet të pasqyrojë nevojat reale të Kosovës e jo zgjidhjet e imponuara nga qasja “të shfrytëzojmë atë që ka mbetur e lirë.”

Znj. Saraçini-Kelmendi shprehu besimin se fqinjët e Kosovës janë në parim të gatshëm për zgjidhje pozitive të këtyre problemeve dhe për koordinim adekuat të planit frekuencor në bazë të parimeve të njejtë me ato të cilat i kanë përdorur fqinjët gjatë planifikimit të tyre. Një gjë e tillë lejohet edhe me Gjeneva 06 ku ekziston hapsira për rregullimin e rasteve të interferencave me mirëkuptim të ndërsjellë. Mos arritura e një zgjidhjeje adekuate do të thoshte që Kosova të vazhdojë me transmetime analoge edhe pas vitit 2015, që do të mund të shkaktonte interferencia në transmetimet në vendet fqinje.

AMPEK-u mendon se për të pasur sukses ky proces në Kosovë, të gjitha palët e interesuara duhet të ulen dhe përpilojnë konceptin. Pastaj, sipas znj. Saraçini-Kelmendi duhet të caktohet ekipi menaxhues i këtij projekti, grupet punuese teknike, ligjore, financiare dhe të përbajtjes, të kërkohet ndihma e ekspertëve të jashtëm, si dhe të krijohen kanalet komunikuese me UNT-në dhe institucionet e tjera ndërkombëtare telekomunikuese. Poashtu duhet të krijohet një plan akcioni i cili do të precizonte konkretisht detyrat dhe afatet për implementim.

Pasqyrë e përgjithshme e UNT dhe marrëveshjes Gjeneva 06

Analizën teknike të planit radio-frekuencor të aprovuar në Gjenevë në vitin 2006 e prezantoi z. Elton Poga, ekspert ndërkombetar dhe këshilltar i KPM-së. Duke folur për marrëveshjen Gjeneva 06 ai theksoi se kjo marrëveshje është nënshkruar nën kornizën e Unionit Ndërkombetar për Telekomunikime (UNT) dhe rregullon transmetimet në bandat VHF 3 dhe UHF 4 dhe 5 për rreth 100 vende Evropiane, Afrikane dhe të Lindjes së Afërt. Kjo marrëveshje zëvendëson një pjesë të marrëveshjes Stokholm 61 për Evropën si dhe një pjesë në marrëveshjes Gjeneva 89 për zonën transmetuese të Afrikës. Data përfundimtare e kalimit u caktua fundi i vitit 2015 dhe deri atëherë stacionet ekzistuese të transmetimit analog duhet të ruhen, gjë që rezulton me kufizime të përkohshme për hyrjet e reja në planin digital.

Objektiva e marrëveshjes ka qenë të plotësohen kërkesat për transmetim digital të të gjitha vendeve që kanë marrë pjesë në këtë proces e në të njejtën kohë të lejohet fleksibiliteti maksimal për përdorimin e spektrit frekuencor në të ardhmen duke përdorur të arriturat teknologjike. Procesi koordinues ka zgjatur dy vite dhe pas një pune intensive edhe përmes konferencave rajonale u arrit deri te marrëveshja Gjeneva 06. Parimi i këtij procesi ka qenë qasja e barabartë në spektrin radio frekuencor për të gjitha vendet. Sugjerimi i UNT-së ka qenë që në bandën 3 të ketë minimum 3 frekuencia për shërbimet audio tramsmetuese digitale tokësore, një kanal në DVBT dhe 7-8 kanale (shtresa) për DVBT në bandet 4 dhe 5. Përbushja e kërkesave për frekuencia që është arritur në marrëveshje është 90% në bandën 3, 90% në bandën 4 dhe 98% në bandën 5. Për territorin Evropian rezultatet janë edhe më të mira, ku vetëm 4 vende Evropiane nuk e kanë arritur shkallën e përbushjes së kërkesave prej 100%.

Fatkeqësish gjatë tërë këtij procesi të rëndësishëm Kosova është përashtuar dhe ajo është përfaqësuar nga Republika e Serb isë. Në takimet rajonale gjatë periudhës Maj 2004 deri në Maj 2006, administrata Serb e ka qenë përgjegjëse për përcaktimin e parametrave teknik për zonën e shërbimit, alotmentet dhe përcaktimin e frekuencave edhe për Kosovën. Në këtë proces i gjithë territori i Kosovës është caktuar si një zonë shërbimi dhe alotimenti. Në të dy bandet frekuencore dimensionet e zonës së mbulimit janë të njejta. Sa i përket zgjedhjes së altomentit, i cili është bazë për të arritur marrëveshje në procesin e koordinimit, Serb ia zgjodhi Reference Network-un RN1, që është rrjeta më e madhe që mund të zgjedhet për një zonë shërbyese, diametri i të cilës në Kosovë është 150 KM. Për Kosovën janë zgjedhur dy lloje të recepcionit, e jashtme e lëvizshme (portable outdoor) dhe mobile. Kjo ka rezultuar me 7 kanale në bandën UHF dhe një kanal në VHF si dhe dy blloqe frekuencore në bandën VHF. Nëse krahasojnë alotmentet për Kosovën dhe vendet fqinje, mund të shohim se Kopaoniku në Serb i ka 10 kanale, Jastrebaci në Serb i poashtu ka 10 kanale, Besna Kobila dhe Popova Shapka në Maqedoni kanë poashtu nga 10 kanale. Në anën tjetër Crni Vërh ka 10 kanale dhe Stresi ka 11 kanale. Lotmentet përipiqat kufitare të Kosovës me Shqipërinë janë në Kukës me 10 kanale dhe Dibër me dhjetë kanale. Në krahasim me këto pika transmetimi kufitare në vendet fqinje, Kosova për tërë territorin e saj i ka vetëm 8 kanale. Administrata Serb e gjatë procesit të planifikimit ka caktuar parametra teknike që nuk kanë të bëjnë asgjë me nevojat reale dhe situatën e vërtetë në Kosovë. Gjatë caktimit të kufinjëve të alotmentit,

të cilat duhet të bazohen në pikën transmetuese, mbulesën e sinjalit, sinkronizimin e arritur si dhe koordinimin e brendshëm dhe ndërkombëtar, Serb ia i ka bërë një dëm shumë të madh Kosovës dhe procesit të digitalizimit këtu. Natyra e marrëveshjes do të duhej të jetë e tillë që të bazohet në filozofinë koordinuese dhe që të ofrohet qasje e barabartë në mundësitetë dhe resurset transmetuese. Rekomandimi nga UNT-ja është që vendet fqinje duhet të zgjedhin përafërsisht dimensione të ngajshme të lotmenteve, posaçërisht nëpër vijat kufitare. Planifikimi frekuencor dhe parametrat teknik të zgjedhura për Kosovën nga adminisrata Serb e mbulojnë me planifikim vetëm 52% të territorit. Ata kanë lënë për Kosovën vetëm dy pika transmetimi dhe atë në Golesh dhe Cvilen dhe fuqia transmetuese është caktuar në 40 DV. Në bazë të matjeve të bëra nga z. Poga me ekipin nga KPM-ja, del se me planin e akorduar Serb, Kosova mbulohet vetëm me 28% të territorit. Mbulesa e territorit të Kosovës është 16.1% në tërësi dhe sinkronizimi në një rrjetë të vetëm frekuencor është i pamundur.

Plani i aprovuar nuk përkon me situatën në Kosovë e as me planin dhe synimet e saj. Një problem i madh është mos përputhshmëria e planit me atë marrëveshje dhe pikave të zgjedhura transmetuese të cilat nuk përkojnë me realitetin. Nëse i shohim hartat, pothuajse gjysma e territorit të Kosovës është lënë jashtë këtij plani. Poashtu rrjeti transetues dhe parametrat e zgjedhur nuk plotësojnë as minimumin e kërkuesave.

Alternativat teknike për planin frekuencor digjital sipas standardeve të UNT-së

Planin alternativ frekuencor të përpiluar nga një grup ekspertësh bazuar në nevojat e Kosovës dhe alokimet frekuencore për vendet fqinje, e prezantoi anëtari i ekipit z. Emil Blakaj. Z. Blakaj theksoi se ky plan është vetëm tentativ dhe se ka nevojë të kalojë nëpër një vlerësim teknik shtesë para se të kompletohet. Qëllimi është që të arrihet tranzicioni në transmetime digitale në Kosovë duke i ofruar Kosovës pozitë dhe qasje të barabartë në brezin frekuencor për planifikimin dhe implementimin e digitalizimit.

Në Kosovë ekzistojnë në total 20 pika transmetuese, përfshi edhe pikat e KTTN, dhe këto krijojnë një rrjetë transmetimi të gjërë. Pikat kryesore të transmetimit përdoren vetëm nga televizonet të cilat kanë licensë për mbulesë kombëtare. Në bazë të hartës së kufinjëve të aplotmentit për Kosovën nga Gjeneva 06, Kosova ka tetë transmetues jashtë territorit të aplotmentit. Rrjeta transmetuese mbulon rreth 75% të territorit të Kosovës, derisa në aspekt të numrit të qytetarëve mbulon rreth 97% të popullatës. Duke marrë parasysh problemet teknike si pasojë e planit të aprovuar në Gjenevë, plani alternativ plotëson nevojat e Kosovës dhe ofron një plan të pranueshëm teknikisht, përfshi edhe specifikimet në aplotmentet e zonave shërbyese. Përcaktimet frekuencore mundësojnë një mbulesë nga një rrjet një frekuencor (single frequency network) i sinkronizuar. Ky plan ofron një ndarje që i vë në harmoni të gjithë parametrat e përmendur. Plani e ndan Kosovën në më shumë aplotmente duke pasë parasysh mbulesën e secilës pikë sipas ndarjes malore në Kosovë në tre zona kryesore. Aplotmenti i parë është zona e Anamoravës ku mbulesa e pikave transmetuese ekzistuese është rreth 80-85% të kësaj zone. Reference network-u i propozuar për këtë planifikim është RN2 derisa pranimi është paraparë të jetë RPC2. Me këto parametra teknik dhe për këtë zonë mund të arrihet rrjeti një-frekuencor, që është shumë e rëndësishme për planifikim digital. Një aplotment tjetër në planin alternativ është aplotmenti i Dukagjinit, përsëri duke përdorur rrjetin një frekuencor, RN2 dhe recepcionin RPC2. Përsëri mbulesa me pikat transmetuese ekzistuese është e mirë, mirëpo përmirësime mund të bëhen edhe përmes mbulesës së vrimave duke përdorur transmetues shtesë, pa shkaktuar asnjë problem apo interferencë. Aplotmenti i tretë i propozuar mbulon Kosovën qendrore dhe Prishtinën. Me infrastrukturën ekzistuese të transmetuesve mbulesa territoriale arrin 91%, mirëpo përsëri kjo mund të shtohet përmes pikave transmetuese, të cilat jane rrjet një-frekuencor, dhe sinkronizimin e pikave transmetuese. Zgjedhja e frekuencave dhe numri i tyre për secilin aplotment është e bazuar në zonat e shërbimit (service area) të aplotmenteve që dalin nga Gjeneva 06.

Principi kryesor për zgjedhjen e frekuencave në planin alternativ ka qenë qasja e barabartë në spektrin radio-difuziv me shtetet fqinje. Në planifikim është përdorur softueri me përbajtjen nga Gjeneva 06 për të gjetur kanalet e lira të cilat nuk do të interferonin me asnjërin aplotment të vendeve fqinje në rajon. Plani për distribuimin e frekuencave varet nga dokumenti i politikave në kuadër të strategjisë për

digitalizim si dhe kërkесat e vërteta për frekuenca dhe oferta programore. Poashtu, duhet të ketë kombinim në mes të ofruesve të radio-difuzionit, sidomos në mes të distribuimit kombëtar, regional dhe lokal. Zgjedhja e kanaleve duhet të koordinohet me vendet fqinje dhe këto zgjedhje të koordinohen dhe testohen nga grupet teknike. Nëse grupet teknike hasin diku në probleme atëherë ato mund të koordinohen me ekspertët e KPM-së si dhe grupet teknike të involvuar në procesin e strategjisë. Kalkulimet për planin e prezentuar alternativ janë bërë duke përdorur sugjerimet e dala nga UNT-ja.

Prezentimi i z. Blakaj, përfundoi duke theksuar nevojën për koordinim në mes të gjitha vendeve. Për të përfunduar kjo çështje, duhet shkëmbyer përvojat si dhe të dhënat teknike me vendet e tjera. Puna e bërë deri tani është e mirë dhe krijon disa embrione të alotmenteve të reja dhe është përgaditje për planin teknik frekuencor mbi transmetimet digitale.

Mundësitë për koordinim dhe bashkëpunim me vendet fqinje për një plan alternativ frekuencor

Seancën e diskutimeve rreth mundësive të koordinimit të Kosovës me vendet fqinje rreth planit alternativ frekuencor që do të mbulonte nevojat e Kosovës dhe do të ofronte qasje të barabartë në brezin frekuencor e filloj znj. Saracini-Kelmendi nga AMPEK-u duke thënë se plani alternativ i prezantuar nga dy ekspertët e KPM-së është një punë e mirë dhe duhet të jetë bazë për planifikimin përfundimtar i cili do të plotësonë nevojat e shikuesve Kosovar. Znj. Saracini-Kelmendi pastaj theksoi nevojën që ky plan të koordinohet së pari brenda Kosovës në mes të të gjitha paltëve të interesuara e pastaj të fillohet me procesin e koordinimit me vendet fqinje. Ajo theksoi se plani frekuencor assesi nuk duhet punuar mbi bazën e frekuencave të cilat kanë mbetur të lira, por duhet të bëhet në bazë të nevojave dhe specifikave të Kosovës, pasi brezi frekuencor është pasuri natyrore e Kosovës.

Agin Sopi, anëtar i Këshillit të KPM-së, theksoi se Kosova si shtet ka të drejtë të planifikojë shfrytëzimin e resurseve të veta. Në kuadër të planit alternativ frekuencor, i cili është vetëm inicial, KPM ka pasur kujdes që të mos shkaktojë interferenca me asnjë vend fqinj, përfshi edhe Serb inë. Z. Sopi përmendi shembullin e Kopaonikut ku Serb ia ka siguruar 11 frekuencia për një territor me jo më shumë se 10,000 banorë që është më shumë se numri i frekuencave që ata kanë caktuar për aplotmentin e Kosovës me 2 milion banorë. Ai theksoi se vendimi i UNT-së për të mos përfshirë Kosovën në planifikimin frekuencor shkel të gjitha konventat mbi të drejtat e njeriut, përfshi këtu të drejtën për informim duke lënë më shumë se 85% të popullatës së Kosovës jashtë frekuencave dhe resurseve të veta natyrore. Megjithëatë, Kosova ka pikat e veta të transmetimit, prej të cilave së paku 2 janë në lartësi më të madhe se 2,000 metra dhe transmetimi nga këto pika mund të arrij në Berlin, Athinë apo Kajro. Ai shprehu besimin se do të ketë vullnet dhe mirëkuptim dhe që Kosova nuk do të detyrohet të futet në një pozitë konfliktuoze. Përashtimi, sipas z. Sopi, nënkupton edhe të drejtën për mbijetesë derisa përfshirja kërkon përgjegjësi dhe obligime. Mirëpo, Kosova ëshë e interesuar për bashkëpunim dhe koordinim sa më të mirë me fqinjët e vet.

Mehdi Këpuska, nga Rditellevizioni i Kosovës, tha se Kosova ka pasur 4 rrjeta të definuara për transmetim analog dhe ky transmetim ka qenë i koordinuar shumë mirë dhe ky plan ka qenë i sinkronizuar brenda UNT-së dhe me fqinjët e Kosovës. Ai theksoi se edhe rrjetet e transmetimit digjital duhet të jenë të bazuarë në parametrat optimal e jo parametrat e skajshëm që do të ishin më të kushtueshëm dhe më problematic për arritjen e sinkronizimit. Prandaj, çfarëdo plani duhet të koordinohet brenda Kosovës e vetëm pastaj me vendet fqinje.

Sipas Fazli Shalës nga Autoriteti Rregullativ për Telekomunikacion, plani alternativ i prezantuar nga z. Blakaj është një bazë e mirë, mirëpo kjo duhet modifikuar edhe më tej. Ai theksoi se përcaktimet në këtë plan si të assignment-eve ashtu edhe të aplotmenteve janë larg nga nevojat e Kosovës dhe në

krahasim me përcaktimet e vendeve fqinjëve. Z. Shala propozoi që për Kosovën të planifikohen së paku 5 zona dhe një tjetër e veçantë për Prishtinën, siç është edhe praktika në të gjitha vendet e tjera. Një mundësi pastaj është që nga pikat transmetuese kufitare të vendeve fqinje të merren disa frekuencia mbulimin hapsirës së atij alotimenti qe bie në territorin e Kosovës. Në këtë proces duhet kontaktuar UNT-ja dhe duhet koordinuar frekuencat e reja me ta.

Z. Poga theksoi se me planin alternativ të paraqitur është arritur sinkronizim 100% dhe se ky plan është akomodues në masë më të madhe për të lejuar një proces më të lehtë të koordinimit me vendet fqinje. Ai u pajtua edhe me idenë e një sub-alotmenti të veçantë për Prishtinën, që do të ishte krahas 4 alotmenteve të parapara për Kosovën. Sipas tij, zgjedhja e frekuencave nuk është e rastësishme dhe i është nënshtuar një procesi llogaritjesh të shumta duke përdorur softuerin që e përdor edhe UNT-ja për planifikim.

Pirro Braço nga autoriteti rregullativ Shqiptar tërroqi vëmndjen në atë se frekuancat e planifikuara duhet të miratohen dhe regjistrohen në regjistrin ndërkombëtar të frekuencave dhe se një gjë e tillë përfshinë koordinim dhe marrëveshje jo vetëm me vendet fqinje por edhe me të gjitha vendet në distancë prej 1,000 km nga Kosova.

Në diskutimet e tyre rreth gatishmërië për koordinim, përfaqësuesit e autoriteteve përkatëse nga vendet e rajonit shprehën gatishmérinë për koordinim me Kosovën ashtu që të lejojnë një proces sa më të lehtë të tranzicionit në transmetim digjital dhe tejkalimin e problemeve që dalin nga marrëveshja Gjeneva 06.

Miha Kriselj nga Sllovenia vërrjeti se kalimi nga një alotment në tre sosh sipas planit alternativ do të krijojë shumë probleme dhe negociata të vështira me vendet fqinje. Duke pasur parasysh se në alotmentet fqinje Kosova ka nga 10 frekuencia të zëna nga Serb ia, Maqedonia dhe Shqipëria, dhe nëse kësaj i shtohen edhe 20 kanale për Kosovën, numri total i kanaleve vjen në mbi 50 kanale, derisa banda UHF ka në dispozicion vetëm 49. Z. Kriselj pyeti se si do te nxirren kanalet shtesë të nevojshme. Ai theksoi se duhet përgaditur një plan të dytë për një situatë nëse negociatat me fqinjët dështojnë. Një zgjidhje alternative e propozuar nga z. Kriselj ishte qe të shfrytëzohen të drejtat nga Gjeneva 06 dhe të zgjerohet zona e mbulimit të alotmenteve ekzistuese nga ajo sa mbulojnë me përcaktimet e tanishme deri në një mbulesë të plotë të territorit të Kosovës. Kjo sipas tij mund të jetë një zgjidhje më e thjeshtë edhe pse mund të krijojë probleme teknike të cilat do të kushtonin më shumë për tu zgjidhur.

Zoran Stefanovski nga Këshilli për Radiodifuzion i Republikës së Maqedonisë u pajtua se problemet e dala nga Gjeneva 06 duhet të zgjidhen me fqinjësi të mirë. Sa i përket Maqedonisë kjo marrëveshje do të duhej të bëhet me Agjencionin për Komunikime Elektronike, i cili është rregulator i infrastruktureve. Z. Stefanovksi shprehu vullnetin e mirë nga Maqedonia për tu ulur dhe diskutuar zgjidhjet konkrete. Ai shprehu rëndësinë e bisedave të KPM-së me UNT-në dhe përfshirjes së saj në këtë proces. Poashtu, deklarimi i qëndrimit të Serb isë rreth këtyre problemeve është i rëndësishëm për këtë proces, që nuk guxon të ndalet.

Jadranka Vojvodiq, nga Agjacioni Transmetues i Malit të Zi, u pajtua se kjo është një çështje shumë e rëndësishme dhe se problemet duhet të diskutohen në mirëbesim dhe në pajtueshmëri me principin

bazë të UNT-së, që është qasja e barabartë ndaj frekuencave dhe qëllimi që ky resurs i vlefshëm të jetë në dispozicion optimal dhe në benefit të qytetarëve. Znj. Vojvodiq theksoi se pala biseduese në Mal të Zi duhet të jetë Ministria e Telekomunikacionit dhe Agjencioni për Komunikime Elektronike.

Pirro Braço, nga rregullatori shqiptar, shprehu poashtu shqetësimin për idenë e miratimit të frekuencave të reja pasi kjo do të mund të mirrte shumë kohë dhe jo gjithësesi të rezultonte e suksesshme. Ai poashtu tha se është mirë të ekzistojë një plan B në mënyrë që të arrihen disa qëllime imediate, mirëpo theksoi se plani alternativ i prezentuar është një plan objektiv dhe bazë e mirë për planifikime në të ardhmen.

Znj. Saraçini-Kelmendi theksoi nevojën që KPM së bashku me institucionet relevante qeveriatre të fillojnë dialogun me palët përkatëse në vendet fqinje. Siças saj, pozita e Kosovës karshi vitit 2006 tani më ka ndërruar dhe Kosova është shtet me 63 njohje dhe rrjedhimisht edhe pozita e saj ndaj UNT-së ka ndryshuar. Këtu znj. Saraçini-Kelmendi shprehu bindjen se në marrëdhënien më UNT-në rol të rëndësishëm ka edhe diplomacia e vendeve fqinje që mund të shtyej drejt bashkëpunimit më të mirë me UNT-në. Kosova ka gatishmëri të mos pengojë dhe interferojë askend dhe është e hapur për diskutime dhe dialog. Mirëpo, nëse nuk gjenden modalitete Kosova s'mund të shpik frekuanca dhe do të duhet që të arrihet një marrëveshje për shfrytëzimin sa më optimal të resurseve natyrore. Nëse nuk zgjidhen problemet me bandin frekuencor, mediat në Kosovë do të vazhdojnë të emetojnë në të njejtat frekuencia si tani dhe kjo mund të hap probleme me vendet fqinje. Afati për marrëveshje është fundi i vitit 2015.

Naile Selimaj-Krasniqi tha se procesi i digjitalizimit mund të konsiderohet si një mozaik. Analiza e planit alternativ frekuencor është pjesë fillestare dhe shumë e rëndësishme për transformimin e transmetimeve. Puna e prezentuar gjatë konferencës si dhe angazhimet e mëtutjeshme si të mediumeve, rregullatorit dhe vendeve fqinje do të mundësojë koordinimet e nevojshme për të gjithë.

Konkluzionet

Konferanca Ndërkombëtare Prezantimi I Transmetimit Digjital Në Kosovë dhe Rajon – Strategjité, mbajtur në Prishtinë më 3-5 dhjetor 2009 u fokusua në prezantimin e procesit të tranzacionit në tranmetim digjital nga vendet e rajonit Ballkanik si dhe në fillimin e diskutimeve për tejkalimin e problemeve që dalin nga përjashtimi i Kosovës prej Marrëveshjes Gjeneva 06.

Nga diskutimi doli se janë të nevojshme dy procese, njëri është koordinimi i brendshëm në mes të rregullatorit dhe transmetuesve dhe një proces tjetër shumë i rëndësishëm, ndoshta edhe pak më i vështirë, është koordinimi i Kosovës me vendet fqinje dhe me UNT-në në një të ardhme.

Pjesëmarrësit u pajtuan se mosgjidhja e problemeve që dalin nga Gjeneva 06 do të shkaktojë pengesa si për zhvillimin e sektorit mediatik dhe për kalimin e transmetimeve nga ai analog në digjital në Kosovë, poashtu edhe probleme për vendet fqinje si dhe për rajoninmë gjerë. Në bazë të Marrëveshjes Gjeneva 06 digjitalizimi në Kosovë është i pamundur, si nga aspekti teknik poashtu edhe nga aspekti social, gjegjësisht nga aspekti i të drejtave të njeriut sepse në këtë mënyrë do të shkelej e drejta e qytetarëve për tu informuar.

Për të tejkular këtë situatë dhe rrethanat momentale si në relacion me UNT-në ashtu edhe në relacion me fqinjët, e posaçërisht me Serbinë, duhet tentuar që në marrëveshje me fqinjët të zgjidhen çështjet e hapura. Fatkeqësisht, Serbia edhe pse e ftuar në këtë konferencë, nuk ka treguar vullnet për t'u bashkangjitur.

Një marrëveshje me fqinjët, që e kanë vullnetin e mirë, do të ofronte një formë të pranueshme për alokimin e frekuencave që do të plotësonin nevojat e Kosovës dhe që poashtu do të respektonin procesin në vendet fqinje. Kjo konferencë ishte hapi i parë në këtë drejtim dhe të gjithë pjesëmarrësit u shprehën të gatshëm që të bëjnë atë çka është e mundur për të arritur një koordinim të drejtë dhe të përshtatshëm për të gjithë. Pjesëmarrësit theksuan se është edhe në interes të Serbisë që në një të ardhme të afërm të bashkangjitet në këtë proces dhe të mos dëmtohet asnjëra palë.

Konkludimet nga konferanca mund të përblidhen si vijon. Pjesëmarrësit theksojnë nevojën për krijimin e dy mekanizmave koordinues: një të brendshëm, i cili do të duhej të ishte në mes të palëve me interes në Kosovë, dhe mekanizmi tjetër koordinues rajonal , i cili do të mund të iniciohej ndoshta me propozimin e Kosovës dhe do të përfshinte autoritetet përgjegjëse nga vendet e rajonit, të cilat mund të preken nga pasojat e mos koordinimit të duhur. Mekanizmi i brendshëm koordinues, duhet t'i paraprij çfarëdo mekanizmi rajonal. Të gjitha palët në tryezë shprehën vullnetin e mirë për të marrë pjesë në një proces të tillë koordinues. Pjesëmarrësit poashtu theksuan nevojën për të konsultuar dhe përfshirë UNT-në në këtë proces, gjë që do të ishte si në interes të Kosovës ashtu edhe të UNT-së në mënyrë që të rregullohet kjo hapësirë e transmetimit.

Aneksi 1 – Fjalimi hyrës nga Jakup Krasniqi, Kryetar i Parlamentit të Kosovës

Inderuar Këshill i KPM-ës,

Enderuara drejtore e KPM-ës,

Tënderuar mysafirë,

Përfaqësues të rregullatorit të rajonit,

Zonja dhe zotërinj,

Ndihem i privilegjuar që Komisioni i Pavarur për Media më ka ftuar ta hap këtë Konferencë me një temë shumë të rëndësishme për Kosovën dhe për rajonin – Transmetimi numerik.

Rregulatorë të transmetimit nga Sllovenia, Kroacia, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia dhe nga Shqipëria, më lejoni të ju shpreh mirëseardhje në Republikën e Kosovës.

Juve dhe të gjithë të pranishmëve ju dëshiroj qëndrim të këndshëm në Kosovë dhe punë të frytshme në këtë Konferencë.

Zonja dhe zotërinj,

Rruja drejt prosperitetit shtrohet me qëllimin të mirë. Ne duhet të sigurohem se do të ofrojmë më shumë se sa vetëm qëllime të mira. Duke u përqendruar në këto qëllime ne do të përmirësojmë standardin dhe shërbimet për secilin qytetar, por gjithashtu do të përmirësojmë edhe pozicionimin e Kosovës në aspektin e integrimeve që është synim i ynë për të ardhmen e vendit.

Zhvillimet e teknologjisë, adaptimi dhe shfrytëzimi i tyre për interesat individuale dhe shoqërore, marrja dhe dhënia e shpejtë e informacionit cilësor dhe të gjithanshëm, është pa dyshim një rrugë e sigurt drejt një shoqërie të hapur, vizionare, kurajoze që mbështet në parimet e zhvillimit dhe kjo poashtu bart rreziqe nga e panjohura.

Uroj që ky aktivitet, me anë të debatit, ndarjes së informacionit rreth eksperiencave të derisotme t'i shërbejë pikërisht zbulimit të së pa njohurës dhe ndërtimit të urave të bashkëpunimit rajonal.

Si qytetar, me pak njohuri mbi teknologjinë, por shfrytëzues i përditshëm i saj, si kryesues i institucionit më të lartë të Kosovës për hartimin e politikave dhe vendimmarrjes, në emër të qytetarëve të këtij vendi do t'i kërkoj këtij forumi dyditor, së pari: të na ofrojë ekspertizë dhe bashkëpunim më të mirë se si mund t'u qasemi çështjeve të digitalizimit të medias nga pikëpamja ligjore dhe politikave publike dhe si mund të ndërtojmë strategji të suksesshme, sa lokale po aq rajonale në këtë fushë. Së dyti: Të na informojë dhe të na propozojë infrastrukturë teknologjike e cila do të siguronte zhvillimin e biznesit, krijimin të vendeve të reja të punës, kosto të ulët të investimeve dhe përfitime për investitorin dhe për individin.

E dimë se demokracia është e shëndetshme dhe e qëndrueshme kur qytetarët e saj përfshihen fuqishëm dhe në mënyrë të lirë në shkëmbimin e informatave dhe të ideve, kur lirshëm shprehin mendimin e tyre dhe mësojnë prej të tjerëve. Interneti dhe format tradicionale të medias mbeten faktor kritik të komunikimit ndërmjet qytetarëve të Kosovës dhe qytetarëve të vendit, të rajonit dhe të botës.

Rrugët e komunikimit duhet tu përkasin të gjithëve dhe të reflektojnë diversitetin e Kosovës dhe të mbarë regionit. Kjo politikë do tu mundësojë qytetarëve të diskutojnë në mënyrë aktive për çështjet që i shqetësojnë dhe që prekin jetën e tyre.

Së fundi, mendoj se kjo qasje e re, do të ndihmojë dhe ushtrojë trysni mbi qeveritë, të rrisin transparencën, tu paraprijnë zhvillimeve dhe kërkesave të kohës për të mirën e qytetarit, të nxisin dhe të lejojnë më shumë pjesëmarrje, më shumë përfshirje në vendimmarrje.

Në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në emrin tim, edhe një herë ju uroj punë të mbarë.

Faleminderit për vëmendjen!

Jakup Krasniqi,

Kryetar i Kuvendit të Kosovës

Aneksi 2 – Fjalimi hyrës nga Daut Demaku, Nën-kryetar i Këshillit të KPM

Inderuari Kryetar i Parlamentit të Kosovës, zoti Krasniqi,

Të nderuar kolegë nga rregulatorët e Shqipërisë, të Bosnjës e Hercegovinës, të Kroacisë, të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe Sllovenisë,

Të nderuar ju anëtarë të Këshillit,

Të nderuar profesionistë të divizioneve të ndryshme të Komisionit të Pavarur për Media,

Të nderuar të gjithë ju, përfaqësues të transmetuesve të Kosovës,

Të nderuar të pranishëm,

Në emër të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media dua të ju përshëndes të gjithëve, të ju dëshiroj mirëseardhje dhe të ju shpreh një falënderim të thellë që keni gjetur kohë e mundësi të merrni pjesë në Konferencën tonë dydlore për digjitalizimin në Kosovë.

Bashkë me falëmnderimin, unë e drejtoj edhe një lutje – që të na ndihmoni sa të keni mundësi, që përvojat tuaja t'i lejoni të bëhen pjesë e përvojës tonë.

Komisioni i Pavarur për Media është agjenci e Kuvendit të Kosovës, është krejtësisht e pavarur dhe ka për detyrë ta rregullojë të sektorin drejtën e mediave në Kosovë.

Në këtë agjenci, është bërë punë e madhe, sidomos pas pavarësisë, pasi kemi trashëguar një parregullsi të plotë, një gjendje aq kaotike që nuk kemi dëshirë ta kujtojmë, aq shumë e çrrëgullt ka qenë.

Për rregullimin e tregut tonë mediatik, ne kemi qenë të detyruar, si të thuash, të fillojmë nga fillimi, t'i rregullojmë të gjitha segmentet prej asaj më të thjeshtës që quhet regjistrim, licencim, prurjen e rregullave themelore që na obligon ligji e deri në licencimin e plotë të të gjitha subjekteve transmetuese me të vetmin qëllim që të krijojmë një gjendje ligjore, një gjendje të rregullt, një gjendje që të jetë njëmend treg medial, me të drejta, detyra dhe obligime që merren për secilin subjekt në atë pjesë të tregut.

Ri-licencimi dhe aktet nënligjore që rregullojnë tregun medial përfundojnë në këtë dhjetor, do të thotë në këtë muaj që jemi. Por, këtu fillon edhe puna tjetër e madhe që quhet – digjitalizim, hyrje në digjitalizim, e që na presin punë dhe detyra shumë të mëdha.

Dua të bëj me dije se kjo agjenci, sipas ligjit, vetë i krijon politikat, strategjitë, detyrat por edhe implementimin e tyre, secilin prej tyre e krijon dhe e implementon vetë në mënyrë të pavarur. Në kuadër të këtyre strategjive, që ia caktojmë vetës sonë, Këshilli i KPM-së ka përcaktuar këtë agjenci ta ketë rolin kryesor dhe udhëheqës në përgatitjen dhe fillimin e digjitalizimit në Kosovë.

Kemi nevojë dhe interes të ju bëjmë ftesë të gjithë faktorëve relevantë në Kosovë, që të involvohen sa më mirë dhe sa më shpejt në këtë proces. Qëllimi ynë është që të krijojmë një plan, një strategji e cila do t'i përshtatet më së miri kushteve dhe specifikave tona në Kosovë.

Këshilli i Pavarur për Media pret mbështetjen maksimale të institucioneve të mediave, të gjithë operatorëve dhe të publikut në mënyrë që procesi të jetë më i lehtë, më i pranueshëm dhe më i dobishëm për atë që quhet konsumator për të cilin të gjithë punojmë.

Këshilli i Pavarur për Media ka përcaktuar objektivin për këtë vit, që të fillojë përgatitjet për digitalizim. Po këto përgatitje kanë për bazë një analizë të planit të përcaktuar nga UNT-ja për vitin 2006 dhe planin alternativ. Për këtë temë dot ë flasin më vonë ekspertët, sepse këtu në Kosovë jemi të dëmtuar shumë dhe këtu nuk është fjala për ndonjë gabim apo një dëmtim të rastësishëm, por është fjala për një dëmtim serioz të cilin duhet ta riparojmë ne vetë.

Organizimi i kësaj konference është hap i madh që e bëjmë për përbushjen e këtij obligimi. Kolegët tanë të vendeve fjinje kanë ecur përpara duke vodosur bazat ligjore teknike dhe duke përcaktuar strategjitë dhe afatet për të kaluar në transmetimin digjital ose si e quajmë shqip numerik.

Këshilli i Pavarur për Mediave është shumë mirënjoyës për marrëdhënie korrekte dhe kolegiale me agjencitë simotra nga vendet e rajonit, që janë ndërtuar dhe po vazhdojnë të pasurohen sidomos viteve të fundit dhe jemi shumë mirënjoyës që ata sot janë këtu me ne për të ndarë përvojat e tyre të mira me ne.

Frekuencat janë asete shtetërore, por frekuencat nganjëherë iu ngjajnë edhe mendimeve, që nuk njojin pengesa, bariera e kufij dhe dalin edhe jashtë territoreve shtetërore duke interferuar të tjerët. Ne dëshirojmë që me të gjithë fqinjët të ndërtojmë marrëdhënie bashkëpunimi në mënyrë që tregu medial të funksionojë mirë dhe pa shkaktuar dëme reciproke te njëri-tjetri.

Prandaj, nga kjo konferencë presim të mësojmë si po ec procesi i implementimit të strategjive të përcaktuara në vendet fjinje, çka po funksionon e çka jo tek ata që kanë përvojë më shumë se ne, çka mund të na këshillojnë sidomos në këtë fazë të përgatitjeve për kalimin nga transmetimi analog në transmetim digital.

Dhe, krejt në fund, në emër të Komisionit të Pavarur për Media edhe një herë dua të ju falënderoj për pjesëmarrje dhe për kontributin tuaj. Besoj se në fund të Konferencës do të dalim më të përgatitur dhe më të gatshëm që të përballemi me sfidat e rënda që na presin, sidomos për punën konkrete në hartimin dhe koordinimin e planit frekuencor.

Uroj që kjo konferencë të ketë punë të mbarë dhe të gjithëve ju dëshiroj shumë sukses.

Daut Demaku

Zëvendës-kryetar, Këshili i Komisionit të Pavarur për Media

Aneksi 3 - Agjenda e konferencës

Prezantimi i transmetimit digjital në Kosovë dhe Regjion

STRATEGJITË

3-5 dhjetor 2009, Grand Hotel, Prishtinë

3 dhjetor 2009

19:30 Hapja dhe darka në Teatrin Kombëtar

4 dhjetor 2009

Sesioni i Parë, Moderator: Bersant Disha

| | |
|---------------|---|
| 09:00-09:30 | Regjistrimi i pjesëmarrësve <i>Hotel Grand</i> |
| 09:30-09:35 | Fjala hyrëse nga z. Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit të Kosovës |
| 10:35 – 10:00 | Hapja e Konferencës nga z. Daut Demaku, Nënkyryetar i Këshillit të KPM-së |
| 10:00-10:20 | Prezantimi i gjendjes së përgjithshme të Mediave në Kosovë z. Naile Krasniqi – SHE KPM |
| 10:20 – 11:00 | Shqipëria: z. Pirro Braço, Këshilli Kombëtarë i Radio Televizionit |
| | Bosnja dhe Hercegovina: z. Amela Odobasic, Agjencia e Rregullatorit për Komunikime |
| 11:00-11:30 | Pushim për kafe |
| 11:30 – 12:15 | Diskutim i panelit: <i>Strategjia për kalim nga sistemi analog në sistem digjital të transmetimit: "Korniza ligjore dhe teknike – mësimi nga përvojat"</i> |
| 12:15 – 12:40 | Diskutime: <i>Pyetje dhe përgjigje</i> |

| | |
|---------------|--|
| 12:40 – 13:20 | Kroacia: z. Damir Hajduk, Këshilli për Media Elektronike |
| | Mali i Zi: znj. Jadranka Vojvodic, Këshilli i Agjencisë për Transmetim |
| 13:20 – 13:40 | Diskutime: <i>Pyetje dhe përgjigje</i> |
| 13:40 - 14:30 | Dreka |
| 14:30-15:00 | Diskutim i panelit (vazhdon): <i>Strategja për kalim nga sistemi analog në sistem digjital të transmetimit: "Korniza ligjore dhe teknike – mësimi nga përvojat"</i> |
| | Maqedonia: z. Zoran Stefanovski, Këshilli për Transmetim |
| 15:20 – 15:40 | Sllovenia: z. Miha Kriselj, Agjencia për Komunikime Post Elektronike |
| | znj. Tanja Kersevan Smokvina |
| 15:40 – 16:00 | Diskutime: <i>Pyetje dhe përgjigje</i> |
| 16:00 – 16:15 | Pushim për kafe |
| 16:15 – 17:00 | Paneli i përbashkët: <i>"Cilat janë praktikat më të mira të mundshme?"</i> Folësit nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Sllovenia |
| 17:00 – 17:30 | Përbledhja e ditës së parë të konferencës |
| 19:30 | Darka (Muzeu i Kosovës) |

5 dhjetor 2009

| | |
|--------------------|--|
| <u>Dita e dytë</u> | <u>"Kosova drejt Digjitalizimit"</u> |
| 09:00- 9:10 | Hapja e ditës së dytë e konferencës, Moderator: Bersant Disha |
| 9:10 – 10:00 | <i>Planet dhe përgatitjet e medias për kalimin e transmetimit nga ai analog në digjital.</i> znj. Afërdita Saraçini Kelmendi, Kryetare e Bordit të AMPEK-ut |

| | |
|---------------|---|
| 10:00 – 11:00 | <i>“Alternativat Teknike për planin frekuencor digjital të Kosovës sipas standardeve të UNT-së</i> |
| | z. Emil Blakaj, Ekspert për Planifikim Frekuencor |
| | z. Elton Poga, Ekspert për Planifikim Frekuencor |
| 11:00 – 11:15 | Pushim për kafe |
| 11:15 – 12:30 | Diskutim i hapur: <i>“Mundësitë e bashkëpunimit lidhur me alternativat e planit frekuencor ”</i> |
| 12:30 – 13:00 | Konkluzionet |
| 13:00 – 14:30 | Dreka (Hotel Grand) |
| 19:30 | Darka për nderë të kolegëve nga Autoritetet e Rregullatorëve “Sheshi 21” |